45. Nervi cranial tek i cili mund të ndodhë dëmtim central apo periferik është:

- A) Nervi II;
- B) Nervi V;
- C) Nervi IX
- D) Nervi VII

46. Anosmia është shenjë e dëmtimit të:

- A) Nervave olfaktorë;
- B) Nervave facial;
- C) Nervave glosofaringealë;
- D) Nervave trigeminalë

47. Ptoza palpebrale haset në dëmtimet e:

- A) Nervit olfaktor;
- B) Nervit okulomotor;
- C) Nervit trigeminal;
- D) Nervit hypogloss.

48. Shenja e "Bell", haset në:

- A) Neuraljinë trigeminale
- B) Paralizën faciale centrale
- C) Paralizën faciale periferike;
- D) Neuraljinë glosso-faringeale.

49. Në dëmtimet e nervit glosso-faringeal kemi humbjen e shijes në:

- A) 1/3 e përparme të gjuhës;
- B) 1/3 e mesme të gjuhës;
- C) 1/3 e pasme të gjuhës;
- D) Gjithë gjuhën.

50. Nervi hypogloss është:

- A) Nerv sensitiv;
- B) Nerv motor;
- C) Nerv miks (sensitivo-motor);
- D) Nerv me funksion parasimpatik.

51. Shenja "Babinski", haset në:

- A) Dëmtime të rrugëve ekstrapiramidale;
- B) Dëmtime të nervave kraniale;
- C) Dëmtime cerebellare
- D) Dëmtime të rrugëve piramidale

52. Tremori cerebellar është tremor:

- A) Intencional, vecanërisht në fund të lëvizjes;
- B) Tremor qetësie;
- C) Me përqëndrim distal;
- D) Shoqëruar me crrëgullime të të folurit.

53. Hypotonia muskulare është:

- A) Pakësim i rezistencës ndaj lëvizjes passive të anësive;
- B) Shtim i rezistencës ndaj lëvizjes passive të anësive
- C) Rezistencë e pandryshuar ndaj lëvizjes passive të anësive
- D) Mungesë e rezistencës ndaj lëvizjes passive të anësive.

54. Skleroza multiple është patologji:

- A) Dismielinizante hereditare;
- B) Dismielinizante e fituar;
- C) Demielinizante;
- D) Metabolike.

55. M. Alzheimer është sëmundje:

- A) Demielinizante;
- B) Degjenerative progressive;
- C) Traumatike;
- D) Metabolike.

56. Në morbus Alzheimer, ndodh:

- A) Humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve parietale e temporal;
- B) Humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve oksipitale e frontale;
- C) Humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve frontale e parietale;
- D) Humbje progressive neuronale në korteksin e lobeve oksipitale e parietale.

57. Termi adenopati i referohet:

- A) Ënjtjes (zmadhimit) të nyjave limfatike
- B) Ënjtjes së zorrëve të mëdha
- C) Ënjtjes së fshikëzës së tëmthit
- D) Ënjtjes së stomakut

58. Defekimi me feçe të gjakosura njihet si:

- A) Gingivitis
- B) Fissurë anale
- C) Hematokezia
- D) Hemorroide

59. Vjellja e gjakut është i njohur si:

- A) Hemorroide
- B) Hemostasis
- C) Hematemesis
- D) Melena

60. Inflammacioni i mëlcisë njihet si:

- A) Cirrozë
- B) Hepatit
- C) Bulimi
- D) Fistul

61. Ndjesia e djegies retrosternale njihet si:

- A) Cardiosis

- B) Pyrosis
- C) Mostretje
- D) Meteorizëm

62. Të vjellat e shtuara njihen si:

- A) Hyperpepsia
- B) Hyperemesis
- C) Hyperamnesia
- D) Hyperfagia

63. Defekimi me feçe në ngjyrë të zezë quhet:

- A) Diarre
- B) Karcinozë
- C) Konstipacion
- D) Melena

64. Inspektimi instrumental i pjesës fundore të zorrës së trashë është i njohur si:

- A) Colostomi
- B) Trakeostomi
- C) Sigmoidoskopi
- D) Tonsilektomi

65. Cila nga të mëposhtmet nuk është patologji e pankreasit?

- A) Pancreatiti akut
- B) Kolecititi akut
- C) Fibroza cistike
- D) Kanceri pankreatik

66. Disfagia është:

- A) Vështirësi në gëlltitje
- B) Vështirësi në tretje
- C) Pamundësi për të përtypur
- D) Vështirësi në defekim

67. Stenoza e lindur e pilorit:

- A) Zakonisht paraqitet që në ditët e para të jetës
- B) Ndodh më shpesh në meshkuj se femra
- C) Paraqitet me të vjella me gjak
- D) Trajtohet me FPP

68. Cirroza është:

- A) Sëmundje kronike degjenerative e mëlçisë
- B) Tumor i gojës
- C) Tumor i stomakut
- D) Prania e gurëve në fshikëzën e tëmthit

69. Një pacient diagnostikuar me hbs Ag (+), propabikish ka:

- A) Një Hepatit B
- B) Koledokolitiazë
- C) Cirrozë biliare primare

D) Kolangit sklerotizant primar

70. Cili ekzaminim gjaku do të ishte më i dobishem për të konfirmuar diagnozën e Cirrozës biliare primare?

- A) Antitrupa Antigliadinë
- B) Antitrupa Antimitokondrial (AMA)
- C) Antitrupa Antinuclear
- D) Niveli i amilazes ne gjak

71. Për cilin nga viruset e hepatitit ekziston vaksina?

- A) Për virusin A
- B) Për virusin B
- C) Për virusin C
- D) Për virusin D

72. Per ulceren peptike jane te verteta pohimet e meposhtme pervec:

- A) Etiopatogjeneza e se ciles ka lidhje me prishjen e ekuilibrit ndermjet faktoreve agresive dhe atyre mbrojtjes te mukozes
- B) Ne etiopatogjeneze ka rol helicobacter pilori
- C) Prek vetem doudenin
- D) Preparatet AIJS kane rol te rendesishem ne shkaktimin e ulcers

73. Lupusi Eritematoz Sistemik është te gjitha pervec:

- A) Semundje me etiologji te njohur
- B) Karakterizohet nga depozitimi i antikorpeve dhe komplekseve imune ne indet dhe qelizat e demtuara prej tyre
- C) Patogjeneza lidhet me faktore gjenetike, ambientale, hormone seksuale
- D) Kemi hiperaktivitet te Lim T dhe B

74. Lupusi Eritematoz Sistemik prek:

- A) Me teper femrat me moshen e riprodhimit
- B) Prek me teper meshkujt
- C) Prek me teper grate ne menopauze
- D) Prek me teper meshkujt ne pubertet

75. Lupusi Eritematoz Sistemik prek me teper:

- A) Femrat e bardha
- B) Femrat me ngjyre
- C) Meshkujt e bardhe
- D) Meshkujt me ngjyre

76. Per Lupusin Eritematoz Sistemik jane te gjitha te verteta pervec:

- A) Semundja mund te preki cdo organ apo sistem
- B) Fillon me shenja te pergjithshme : dobesi, temperature subfebrile, lodhje
- C) Semundja ka shfaqje ne lekure
- D) Nuk shoqerohet me alterime hematologjike

77. Antikorpet antinuklear:

- A) Perbejne nje shenje laboratorike kryesore ndonese jo specifike per LES

- B) Nuk jane positive ne patologji te tjera
- C) Shkohen ne mikroskop te zakonshem
- D) Nuk perbehet nga nentipa antikorpesh

78. Per mjekimin e LES perdoren te gjitha preparatet e meposhtme pervec:

- A) Preparate AIJS
- B) Antimalarike te sintezes
- C) Preparate citotoksike
- D) Levotiroksine

79. Artriti Reumatoid është nje semundje per te cilen jane te verteta te gjitha pervec:

- A) Prek afersisht 0.8% te popullates
- B) Femrat preken me shume se meshkujt
- C) Semundja është me shpësthtë ne dekadën e pare dhe te dyte te jetes
- D) Karakterizohet nga prania e sinoviteve inflamatore persistentete

80. Artralgjia ne Artritin Reumatoid është:

- A) Jo simetrike
- B) Pa rritje te ndjeshmerise gjate palpimit dhe enjtje te artikulacioneve te prekura
- C) Preken me shume artikulacionet e vogla te gishtave
- D) Inflamacioni per kohe te gjate nuk shkakton deformim artikulacionesh

81. Shfaqet ekstrartikulare te AR perfshijne te gjitha pervec:

- A) Prekjen pulmonare
- B) Crrregullimet hematologjike
- C) Crrregullimet okulare
- D) Pranine e hiperkeratozes dhe atrofise se lekures

82. Mjekimi farmakologjik i HTA perfshin te gjitha pervec:

- A) Metotreksat
- B) Betablokues
- C) Ace inhibitore
- D) Antagoniste te kalciumit

83. Faktore ambientale qe favorizojne krijimin e HTA jane te gjitha pervec:

- A) Alkoli
- B) Obeziteti
- C) Dieta e pasur me kalcium
- D) Aktiviteti fizik

84. Mjekimi i HTA perfshin te gjitha pervec:

- A) Aktivitetin fizik
- B) Shtimi i ne peshe
- C) Kufizimi i kripes
- D) Lenia e alkolit

85. Sklerodermia:

- A) Patogjeneza e semundjes është e sqaruar plotesisht
- B) Nuk është e lidhur me faktore nderveprues gjenetik dhe mjedisor
- C) Karakteristike per semundjen është prania e fibrozës se lekures

D) Semundja prek me teper meshkujt se femrat

86. Dermatomioziti dhe polimioziti:

- A) Nuk jane semundje autoimune
- B) Te semuret nuk ankohen per dobesi dhe dhimbje muskujsh
- C) Keta te semure kane alterime te cpk, sgot, sgpt, cpk
- D) Keta te semure nuk kane autoantikorpore

87. Rashi ngjyre lejla rreth syve është tipik per:

- A) Dermatomiozitin
- B) Polimiozitin
- C) Sindromin sjogren
- D) Sklerodermine

88. Te semuret me miopati kane:

- A) Dobesi te muskujve distale
- B) Dobesi te muskujve proksimale
- C) Dobesi te qafes
- D) Nuk kane shqetesime te lokalizuara

89. Ne polimiozitet jane te pranishme antikorporet:

- A) ANA
- B) Anti-dsadm
- C) FR
- D) Jo-1

90. Klasifikimi i vaskuliteve paresore bazohet ne:

- A) Agresivitetin e semundjes
- B) Permasat e vazave te prekura
- C) Ekzistojne dy klase vaskulitesh
- D) Nuk ka ndryshuar gjate viteve

91. Granulomatoza Wegener është:

- A) Vaskulit i vazave te medha
- B) Është vaskulit granulomatoz i aparatit respirator i shoqeruar dhe me glomerulonefrit
- C) Te semuret nuk kane demtime otojatrike
- D) Eshe vaskulit i vazave mesatare

92. Spondiliti ankilozant është semundje:

- A) e femrave ne dhjetevjecarin e katert te peste te jetes
- B) e meshkujve ne dhjetevjecarin e dyte dhe te trete te jetes
- C) e grave ne menopauze
- D) infektive

93. Ne spondilitin ankilozant FR dhe ANA:

- A) Ne spondilitin ankilozant FR dhe ANA jane negative
- B) Ne spondilitin ankilozant FR është negative ANA është pozitive
- C) Ne spondilitin ankilozant FR dhe ANA jane pozitive
- D) Ne spondilitin ankilozant FR është pozitive ANA është negative

94. Ankesat e te semurit me spondilit ankilozant:
- A) Rendohen nga aktiviteti fizik
  - B) Nuk ndikohen nga aktiviteti fizik
  - C) Ngurtesimi mengjezor zgjat 15 min
  - D) Ankesat e te semurit rendohen ne mengjes dhe permiresohen gjate aktivitetit fizik
95. Spondiliti ankilozant mjekohet:
- A) Me terapi medikamentoze dhe terapi fizike
  - B) Vetem me terapi medikamentoze
  - C) Vetem me terapi fizike
  - D) Nuk ka nevojte per mjekim shume te gjate pothuajse gjithe jeten
96. Podagra fillon zakonisht ne:
- A) Artikulacionin e gjurit
  - B) Artikulacionet e gishtave te duarve
  - C) Artikulacionin e qafes
  - D) Gishtin e madh te kembes
97. Panusi është strukture histologjike qe vihet re tek te semuret me:
- A) Lupus Eritematoz Sistemik
  - B) Sklerodermi difuze
  - C) Artrit Reumatoid
  - D) Dermatomiozit
98. Shfaqet ekstrartikulare me te rralla qe vihen re ne Artritit Reumatoid jane:
- A) Nderlikimet kardiake
  - B) Demtimet ne veshka
  - C) Vaskuliti reumatoid
  - D) Demtime te syve
99. Manifestimi me i zakonshem dhe nga me te hershmit qe vihet re ne Morbus Bekteriev është:
- A) Rashi malar ne forme fluture
  - B) Artriti simetrik i artikulacioneve te vogla te duarve
  - C) Sakroileiti
  - D) Polifagi dhe polidipsi
100. Glukokortikosteroidet e injektueshem ne artikulacione indikohen te perdoren ne patologjite muskuloskeletike:
- A) Inflatore
  - B) Mekanike
  - C) Ne prani te osteoporozes
  - D) Ne prani te frakturave
101. Pneumonia atipike karakterizohet nga keto shenja pervec:
- A) Dobesi trupure
  - B) Dhimbje koke
  - C) Koll e thate
  - D) Melena

102. Hipotiroidizmi shfaqet me simptomat e meposhtme pervec:

- A) Krampe muskulare
- B) Tolerance ndaj te ftohtit
- C) Konstipacion
- D) Gjendje te pergjumur

103. Cili nga medikamentet konsiderohet si linja e pare e mjekimit ne depresionin madhor dhe crregullimin obsesiv kompulsiv?

- A) Inhibitorët selektive te rikapjes se serotoninës
- B) Antidepresantët triciklike
- C) Stabilizuesit e humorit
- D) Benzodiasepinat

104. Sindroma Kushing:

- A) Është semundje qe vjen si pasoje e zvogelimit te prodhimit te kortizolit nga gjendra mbiveshkore
- B) Është semundje qe vjen si pasoje e shtimit te prodhimit te kortizolit nga gjendra mbiveshkore
- C) Është semundje qe karakterizohet nga dhimbja e mesit dhe ngurtesimi mengjezor
- D) Ne kete semundje mungojne Shënjat e virilizmit si depozitimi i dhjavit ne regjionet ndermje shpatullave

105. Te gjitha sa me poshte jane te verteta per IRA prostrenale pervec:

- A) Është mjaft e shpështë ndermjet te semureve ambulatorë
- B) Prek me shume burrat sesa grate
- C) Ne shumicen e rasteve i detyrohet bllokimit uretral ose uretral
- D) Shkaktohet nga medikamente qe reduktojnë filtrimin glomerular

106. Terapia e spondilitit ankilozant perfshin:

- A) Vetem terapi medikamentoze
- B) Terapi medikamentoze dhe fizike
- C) Levotiroskine dhe deksametazon
- D) Desmopresine dhe indometacine

107. Karakteristike per sindromen Kushing është prania e te gjithave pervec:

- A) Hiperkalemise
- B) Alkalozia metabolike
- C) Prodhimi ektopik i ACRH
- D) Artriti simetrik i artikulacioneve interfalangeal proksimal

108. Te semuret me poliarterit nodoz kutan kane:

- A) Renie ne peshe
- B) Temperature
- C) Demtime ne organe
- D) Noduse subkutane

109. Faktore risku per krijimin e infeksioneve te rrugev urinare jane te gjitha pervec:

- A) Shtatezania
- B) Diabeti
- C) Aktiviteti seksual
- D) Prania e osteoartritit bashkeshoqerues.



110. Cila prej semundjeve te meposhtme muskulo-skeletike karakterizohet nga prania e nyjeve te Heberdenit?

- A) Lupusi eritematoz sistemik
- B) Artriti reumatoid
- C) Sclerodermia
- D) Osteoporoza

111. Pamja radiologjike e shkopit te bambuse është tipike per cilen patologji:

- A) LES
- B) AR
- C) Polimiozit
- D) Morbus Bekteriev

112. Sakroileiti është shenje fillestare e ciles prej ketyre patologjive:

- A) Sklerodermi
- B) Artrit reumatoid
- C) Osteoartrit
- D) Morbus Bekteriev

113. Aspirina nuk ka efekt:

- A) Efekt analgjezik
- B) Efekt antinflamator
- C) Efekt analgjezik
- D) Efekt sedativ

114. Guret ne veshka:

- A) Nuk shkaktohen nga hiperkalciuria apo hiperoksaluria
- B) Levizja e gurit ne sistemin ekskretor nuk shkakton dhimbje
- C) Guret e pelvisit renal mund te jene asimptomatike apo te shkaktojne vetem hematuri
- D) Shume pak prej gureve perbehen nga oksalatet e kalciumit

115. Nje pacient 53 vjecar i cili mjekohet me ibuprofen 400mg dy here ne dite per te kuruar dhimbjen kronike te mesit krijon edeme e ekstremiteteve te poshtme. Infermierja qe kujdeset per te mendon se edema është rezultat i:

- A) Uljes te funksionit renal
- B) Uljes se nivelit te kreatinines
- C) Rritje te filtrimit glomerular
- D) Rritje te nivelit te proteinave plazmatike

116. Ne sklerodermine e lokalizuar ka demtime:

- A) Vetem te miokardit
- B) Vetem renale
- C) Vetem gastrointestinale
- D) Vetem te anesive

117. Arteriti Takayasu është inflamacion granulomatoz i arterieve:

- A) Te vogla
- B) Te medha
- C) Te mesme

D) Nuk është inflamacion granulomatoz

118. Etiopatogjeneza e bronkitit kronik mendohet të lidhet me shkaktaret e mëposhtem përveç:

- A) Me tymin e duhanit
- B) Ekspozimi ndaj pluhurave profesionale
- C) Infeksione të shkaktuara nga mykoplazma pneumonie
- D) Ndotja atmosferike

119. Në mjekimin e pneumonisë përdoren më shpesh preparatet e mëposhtme përveç:

- A) Ampicilina
- B) Cefotaxidina
- C) Eritromicina
- D) Metotreksati

120. Rol të rëndësishëm në vendosjen e diagnozës së pneumonisë ka:

- A) Radiografia pulmonare
- B) Torakocenteza dhe biopsia e pleurës
- C) Shintigrafia
- D) Testet kutane

121. Mjekimi i cirrozës alkoolike përfshin të gjitha përveç:

- A) Dieta
- B) Nderprerje të marrjes së alkoolit
- C) Vitamin terapi
- D) Voltaren në doza të larta

122. Hipertensionin pragu konsiderohet:

- A) Me shumë se 180 mmhg dhe ose me shumë se 105
- B) Sistolike 140-180 mmhg dhe ose diastolike 90-105
- C) Sistolike 140-180 mmhg dhe ose diastolike 90-95
- D) Sistolike me më së shumti 140 mmhg dhe diastolike me më së shumti 90 mmhg

123. Faktor madhor rrisi për SAK janë të tërë përveç:

- A) Dislipidemia
- B) Niveli i lartë i kolesterolit
- C) Inaktiviteti fizik
- D) Anamneza familjare

124. A është e vërtetë se:

- A) Me rritjen e moshës rritet rrisi për SAK
- B) Me rritjen e moshës ulët rrisi për SAK
- C) Nuk ka asnjë lidhje të SAK me moshën
- D) Moshë është faktor rrisi madhor për SAK

125. Oliguria përcaktohet si sekretimi i:

- A) më së pak se 400 ml/ urine në ditë
- B) më së pak se 200 ml/ urine në ditë
- C) më shumë se 3 l/ urine në ditë
- D) më së pak se 100 ml/urine në ditë

126. Anuria percaktohet si sekretimi i:

- A) me pak se 300 ml/ urine ne dite
- B) me pak se 400 ml/ urine ne dite
- C) me shume se 2 l/ urine ne dite
- D) me pak se 100 ml/urine ne dite

127. Ne crregullimet e ritmit bejne pjese:

- A) Takikardia sinusale
- B) Bradikardia sinusale
- C) Flateri atrial
- D) Infarkti i miokardit

128. Osteoporoza mjekohet me:

- A) Bifosfonate
- B) Kripa te arit
- C) D- penicilamine
- D) Azatioprine

129. Crregullimet e ritmit sinusal perfshijne te gjitha pervec:

- A) Takikardia sinusal
- B) Bradikardia sinusale
- C) Fibrilacioni atrial
- D) Aritmia sinusale dhe disfunksioni i nyjes sinusale.

130. Polakiuria është:

- A) Urinim naten
- B) Urinim me djegje
- C) Urinim i shpështë
- D) Urinim i dhimbshem

131. Enuresis nocturna është:

- A) Urinim i dhimbshem
- B) Urinim me djegje
- C) Urinim i shtuar
- D) Urinim naten

132. Lupusi eritematoz sistemik është semundje qe prek:

- A) meshkujt me shpesh se femrat
- B) femrat e bardha me shpesh se ato me ngjyre
- C) me shpesh femrat dhe ka incidence me te madhe ne grate me ngjyre
- D) njelloj si meshkujt dhe femrat

133. Tiroidja normale:

- A) Është e palpueshme
- B) Nuk është e palpueshme
- C) Është e palpueshme vetem tek meshkujt
- D) Është e palpueshme vetem tek femrat

134. Steoartriti është semundje:

- A) inflamatore muskuloskeletike

- B) degjenerative muskuloskeletike
- C) endokrine
- D) gjenetike

135. Per mjekimin e morbus Graves perdoren te gjitha pervec:

- A) Karbimazoli
- B) Metimazoli
- C) Indometacina
- D) Propiltiuracili

136. Shkaktare te hipertiroidizmit jane te gjitha pervec:

- A) Semundjet autoimune
- B) Patologji tumorale
- C) Patologji inflamatore
- D) Atireoza

137. Morbus Bazedov:

- A) Prek me shpesh femrat e moshes 30 deri ne 50 vjec
- B) Mungon ekzoftalmia
- C) Funkzioni kardiak eshte normal
- D) Mungon osteoporoza

138. Rreziqet e hipotiroidizmit jane te gjitha pervec:

- A) Koma miksedematoze
- B) Aksidentet kardiake
- C) Prania e astenise
- D) Nervoziteti

139. Eshte i pranishem diabeti kur:

- A) Glicemia esell ne dy dozime eshte me e larte se 1.40 g/l
- B) Glicemia esell ne dy dozime eshte me e larte se 2.40 g/l
- C) Glicemia esell ne dy dozime eshte me e larte se 0.20 g/l
- D) Glicemia esell ne dy dozime eshte me e larte se 0.10 g/l

140. Ne komplikacionet metabolike akute te diabetit hyjen te gjitha pervec:

- A) Acidoketoza
- B) Koma hiperosmolare
- C) Mikroangiopatia diabetike
- D) Hipoglicemite

141. Diabeti i tipit te pare mjekohet me:

- A) Daonil
- B) Metformine
- C) Insuline
- D) Diete hiperkalorike

142. Diabeti i tipit te dyte mjekohet me:

- A) Daonil, metformine
- B) Insuline
- C) Diete hiperkalorike

D) Kufizim i aktivitetit fizik

143. Tension arterial normal konsiderohen vlerat e mëposhtme:

- A) Sistoliku me i vogël se 140 mmhg dhe diastoliku me i vogël se 90 mmhg
- B) Sistoliku me i madh se 140 mmhg dhe diastolike me i madhe se 90 mmhg
- C) Sistoliku ndërmjet 160-180 mmhg dhe diastolike 90-120 mmhg
- D) Sistoliku me i madh se 190 mmhg dhe diastoliku me i madh se 100 mmhg

144. Pavioni kirurgjikal është vendi ku:

- A) Trajtohen të sëmurët
- B) Trajtohen të sëmuret kirurgjikal
- C) Shtrohen për trajtim të sëmurët kirurgjikal
- D) Asnjëra

145. Shtrimi në pavionin kirurgjikal tek adultët bazohet:

- A) Në bazë të seksit
- B) Në bazë të parimeve të asepsisë
- C) Në bazë të moshës
- D) Asnjëra

146. Plaga nuk quhet:

- A) E pastër
- B) E kontaminuar
- C) E infektuar
- D) Asnjëra

147. Kateteri është për përdorim:

- A) Venoz
- B) Urinar
- C) Nazo-gastrik
- D) Të gjitha

148. Ka kapsul piogjene:

- A) Abscesi
- B) Flegmona
- C) Celuliti
- D) Asnjëra

149. Nuk është e vërtetë në obezitet:

- A) Haset shpesh
- B) Gjendet më shumë në meshkujt
- C) Faktor predispozues mund të jetë rritja e estrogjeneve në gjak
- D) Lidhet me nënshqyerjen

150. Nuk është sëmundje kirurgjikale:

- A) Ulcera e perforuar
- B) Kanceri i stomakut
- C) Ulcera stenozaante grada IV
- D) Asnjëra

151. Përbën urgjencë kirurgjikale:

- A) Kalkuloza e kolecistës
- B) Akalazia e ezofagut
- C) Hernia strangulative
- D) Noduli i ftohtë i tiroides

152. Kanceri i gjirit prek më shpesh:

- A) Kuadratin medial të sipërm
- B) Kuadratin medial të poshtëm
- C) Kuadratin lateral të poshtëm
- D) Kuadratin lateral të sipërm

153. Përdorimi i garzave hyn në:

- A) Antiseptiken fizike
- B) Antiseptiken kimike
- C) Antiseptiken mekanike
- D) Të gjitha

154. Në pozicionimin e pacientit në tavolinën e operacionit duhet pasur parasysh:

- A) Të evitohet komprimimi abdominal i tejzgjatur
- B) Të përdoren metodat që parandalojnë dekubituset
- C) Të evitohet aplikimi për kohë të gjatë në gjymtyrë i lakut hemostatik
- D) Të gjitha

155. Operacioni ku nuk përdoret antibioprofilaksia, është në:

- A) Ezofag
- B) Kalkulozet e kolecistës
- C) Tumor tekolonit
- D) Të gjitha

156. Nuk është urgjencë ekstreme kirurgjikale:

- A) Ruptura e lienit
- B) Ruptura kataklizmike e barrës ekstrauterine
- C) Hembolia arteriale mezenteriale
- D) Asnjëra

157. Një hemorragji konsiderohet e rëndë po qe se:

- A) Aspirimi gastrik sjell pa ndërprerje gjak të kuq
- B) Melena e ujshme përsëritet në intervale të shkurtra kohe
- C) Për të mbajtur presionin venoz dhe arterial afër shifrave normale janë të nevojshme transfuzione të shumta
- D) Të gjitha

158. Nuk është origjinë e hemorragjisë digjестive te cirrotiket:

- A) Ruptura e variceve të ezofagut
- B) Turbullimet e hemostazës
- C) Turbullimet trofike të mukozës + staza venoze nga hipertensioni portal
- D) Asnjëra

159. Shkaqet më të shpeshta të alterimeve të ventilimit në gjendjet e emergjencës janë:

- A) Pneumotoraksi valvular
- B) Hemotoraksi masiv
- C) Frakturat multiple të brinjëve ("flail chest")
- D) Të gjitha

160. Rektosigmoidoskopia në një hemorragji të poshtme tregon praninë e një:

- A) Hemorroide të gjakosur
- B) Tumori
- C) Procesi inflamator
- D) Të gjitha

161. Ileusi akut i zorrës së hollë nuk ka origjinë nga:

- A) Herniet interne
- B) Briljet
- C) Tumoret rektale beninje
- D) Ileusi biliar

162. Nuk është okluzion nga shtrëngimi ai i shkaktuar nga:

- A) Brilja
- B) Volvusi
- C) Invaginacioni
- D) Ileusi biliar

163. Është okluzion nga obstruksioni ai i shkaktuar nga:

- A) Tumoret beninje të zorrës
- B) Tumoret malinje të zorrës
- C) Ileuset biliar
- D) Të gjitha

164. Kolecistiti akut kalkuloz nuk është urgjencë absolute kirurgjikale:

- A) Në peritonitin biliar
- B) Piokolecistitin
- C) Kolecisto pankreatitin
- D) Gangrenën e kolecistës

165. Infeksioni i rrugëve limfatike quhet:

- A) Mastit
- B) Limfadenit
- C) Limfangoid
- D) Asnjëra

166. Kolecistiti akut nuk konsiderohet rast i "keq" kirurgjikal në:

- A) Pacientët geriartrik
- B) Insuficiencën renale
- C) Në obezitet
- D) Në lehon

167. Hemorragjia nga barra ekstrauterine është:

- A) Hemorragji digjестive e lartë

- B) Hemorragji digjестive e poshtme
- C) Hemorragji retroperitoneale
- D) Hemoperitoneum

168. Defibrilatori nuk është:

- A) Një pajisje me anë të të cilit i jep pacientit një shkarkim elektrik të kontrolluar për të ndërprerë një aritmi
- B) Një pajisje me anë të të cilit i jep pacientit një shkarkim elektrik të pakontrolluar për të ndërprerë një aritmi
- C) Një pajisje që ushqehet me bateri të karikueshme ose rrjet të vazhdueshëm tensioni
- D) Asnjëra

169. Salla operatore është vendi ku:

- A) Trajtohen kirurgjikalisht të sëmurët
- B) Shtrohen për trajtim pacientët
- C) Shtrohen për trajtim pacientët kirurgjikal
- D) Trajtohen intensivisht të sëmurët kirurgjikal

170. Është parimi më i rëndësishëm në ndarjen në dhoma të të sëmurëve kirurgjikal:

- A) Mosha
- B) Seksi
- C) Asepsia
- D) Asnjëra

171. Nuk është karakteristike në ileusin mekanik:

- A) Ndalimi i feçeve dhe gazrave
- B) Nauze e të vjella
- C) Dhimbja abdominale
- D) Mungesa e hidroniveleve në ro-grafi

172. Agjenti më i vlefshëm i përdorur si sterilizues te autoklavi është:

- A) Ajri ujqor nën presion
- B) Forma e autoklavit
- C) Koha
- D) Nxehtësia

173. Është komplikacion i ndërhyrjeve venoze qëndrore:

- A) Pneumotoraksi
- B) Hemotoraksi
- C) Limforrea
- D) Të gjitha

174. Ulcerat e lëkurës mund të jenë me origjinë:

- A) Vaskulare
- B) Traumatike
- C) Neoplazike
- D) Të gjitha

175. Nuk është karakteristike e fazës akute të infeksionit:

- A) Dhimbja



- B) Temperatura
- C) Leukopenia
- D) Hiperemia

176. Është inflamacion i gjendrave limfatike:

- A) Adeniti
- B) Celuliti
- C) Furunkuli
- D) Limfangoidi

177. Nuk është parametër kryesor në vlerësimin e gjendjes së të ushqyerit:

- A) Klinik
- B) Immunologjik
- C) Dietetik
- D) Biomoral

178. Nuk është e vërtetë për ushqimin parenteral:

- A) Është ushqim artificial i pacientit kirurgjikal
- B) Merret me rrugë venoze
- C) Merret me rrugë arteriale
- D) Merret kur ushqimi oral ose enteral janë të pamundur

179. Cila nga këto plagë është plagë e pastër:

- A) Plaga traumatike e bërë brenda 8 orëve të para
- B) Plaga nga djegiet
- C) Plaga operatore
- D) Të gjitha

180. Materialin qepës (suturat) nuk e ndajmë në bazë të origjinës së materialit përberës në:

- A) Natyral
- B) Artificial
- C) Sintetik
- D) Asnjëra

181. Portagia është instrument kirurgjikal që përdoret për:

- A) Të suturuar
- B) Të diveriguar
- C) Të mbajtur agen
- D) Të mbajtur lamën

182. Kirurgji mini invazive quhet:

- A) Lapartomia
- B) Torakotomia
- C) Laparoskopia
- D) Asnjëra

183. Nuk është urgjencë kirurgjikale:

- A) Hemorragjia digjестive
- B) Ulcer bulbi duodeni e perforuar
- C) Kalkuloza e kolecistës

D) Apendiciti akut

184. Antiseptiken nuk e ndajmë në:

- A) Fizike
- B) Kimike
- C) Biologjike
- D) Asnjëra

185. Është urgjenca më e shpeshtë kirurgjikale:

- A) Hemorragjia digjестive
- B) Ulcer bulbi duodeni e perforuar
- C) Apendiciti akut
- D) Kalkuloza eolecistës

186. Fluktuacioni është karakteristike për:

- A) Flegmonen
- B) Limfangoidin
- C) Abscesin
- D) Asnjëra

187. Fibrogastroskopia mund të jetë mjet trajtimi për:

- A) Hemorragjinë digjестive
- B) Perforacionin e ulçerës duodenale
- C) Stenozën pylorike
- D) Peritonitin post ulçerës së perforuar

188. Nuk ndodh në hemorragjinë gastro intestinale:

- A) Melene
- B) Hemoptizi
- C) Hematemeza
- D) Anemia

189. Është karakteristike në ileusin mekanik:

- A) Ndalimi i feceve dhe gazrave
- B) Nauze e të vjella
- C) Prania e hidroniveleve në ro-grafi
- D) Të gjitha

190. Nuk është komplikacion i ndërhyrjeve venoze qendrore:

- A) Pneumotoraksi
- B) Nënushqyerja
- C) Limforrea
- D) Embolia

191. Është karakteristike e fazës akute të infeksionit:

- A) Dhimbja
- B) Temperatura
- C) Leukocitoza
- D) Të gjitha

192. Nuk është e vërtetë për abscesin:

- A) Prania e kapsulës piogjene
- B) Prania e fluktuacionit
- C) Mund të jetë i nxehtë / i ftohtë
- D) Të gjitha

193. Është inflamacion i gjendrave të djersës:

- A) Adeniti
- B) Celuliti
- C) Hidroadeniti
- D) Furunkuli

194. Nuk është parametër kryesor në vlerësimin e gjendjes së të ushqyerit:

- A) Klinik
- B) Imunologjik
- C) Dietetik
- D) Biomoral

195. Nuk është e vërtetë për ushqimin enteral:

- A) Është ushqim artificial i pacientit kirurgjikal
- B) Merret me rrugë venoze
- C) Merret me rrugë arteriale
- D) Të gjitha

### **3. Bazat e Infermieristikës, Kirurgji, Anestezi e Infektiv**

1. Ajo degë e filozofisë që merret me standartet e sjellje dhe të gjykimit moral quhet:

- A) Deontologji
- B) Vlerë
- C) Detyrë
- D) Etikë

2. Nëse një infermiere përdor uniformen e saj jashtë mjediseve spitalore quhet fajtorë pasi ka thyer:

- A) Të drejtat e pacientit
- B) Kodin etik
- C) Ligjin
- D) Parimet

3. Cili nga këta elementë bën pjesë në konceptet e teorisë infermiere?

- A) Besnikëria
- B) Bamirësia
- C) Autonomia
- D) Infermieristika

4. Cili nga këta elementë bën pjesë në specialitetet infermiere?

- A) Infermieri anestezi
- B) Infermieri si avokat
- C) Infermieri si vendimarrës

D) Infermieri si edukues

5. Homeostaza psikologjike nënkupton një ekulibër të sistemit:

- A) Respirator
- B) Urinar
- C) Gastro-intestinal
- D) Mendor

6. Në nevojat fiziologjike të pacientit bën pjesë ajo për:

- A) siguri
- B) dashuri
- C) ujë
- D) mbrojtje

7. Një person mund të qëndroj pa oksigjen jo më shumë se:

- A) 1-2 min
- B) 2-3 min
- C) 3-4 min
- D) 4-5 min

8. Cila nga këto nevoja fiziologjike është më e rëndësishme ndër të tjerat?

- A) Nevoja për oksigjen
- B) Nevoja për ujë
- C) Nevoja për ushqim
- D) Nevoja për gjumë

9. Aftësia për të influencuar tek të tjerët, për tu perpjekur për një vision, qëllim ose për të ndryshuar qubet:

- A) Menaxhim
- B) Organizim
- C) Planifikim
- D) Lidërsip

10. Lidërsipi drejtues është:

- A) Demokratik
- B) Autoritar
- C) Planifikues
- D) Organizues

11. Sa kohë harxhojnë menaxherët duke komunikuar me persona të ndryshëm, gjatë procesit të menaxhimit:

- A) 30-40% të kohës
- B) 40-50% të kohës
- C) 50-70% të kohës
- D) 75-90% të kohës

12. Cili nga këto element bën pjesë në parimet e ruajtjes së shëndetit?

- A) Gjëndja emocionale
- B) Parandalimi i drogës & duhanit
- C) Biografia kulturore

D) Faktorët social

13. Cfarë perjeton pacienti në stadin e 5 të sëmundjes?

- A) Përjeton simptomat
- B) Pranon rolin si i sëmurë
- C) Kontakton me kujdesin shëndetësor
- D) Perjeton shërimin dhe rehabilitimin

14. Në një poliklinikë nuk bën pjesë një nga këto specialitete të mëposhtme:

- A) Mikrosalla
- B) Laboratori
- C) Konsultat e fëmijeve
- D) Salla operacionit

15. Kur një pacient ndodhet në ambulancën e pranimit mund të drejtohet në një prej strukturave të mëposhtme për trajtimin e tij. Cila prej tyre nuk është struktura e saktë?

- A) Në terapinë intensive
- B) Në sallën e operacionit
- C) Në pavion
- D) Në dhomën e injeksioneve

16. Një pacient pasi del nga salla e operacionit transportohet në:

- A) Dhomë injeksionesh
- B) Në terapinë intensive
- C) Laborator
- D) Mikrokirurgji

17. Sëmundjet kronike janë sëmundje të cilat kanë një kohëzgjatje:

- A) 1 muaj
- B) 2 muaj
- C) 3 muaj
- D) Mbi 3 muaj

18. Sa nivele të kujdesit parandalues ndaj sëmundjes kemi?

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

19. Cila nga këto kujdesje bën pjesë në parandalimin tretësor?

- A) Edukimi shëndetësor
- B) Diagnostimi i sëmundjes
- C) Trajtimi i sëmundjes
- D) Parandalimi i komplikacioneve

20. Temperatura e dhomës në mjediset spitalore tek fëmijet dhe tek të moshuarit duhet të mbahet:

- A) 26-27°C
- B) 24-26°C
- C) 22-24°C

D) 20-22°C

21. Cila është ngjyra që përdoret për të lyer muret në sallat e operacionit?

- A) E bardhë
- B) E kuqe
- C) E verdhë
- D) Jeshile

22. Lagështia e pranueshme e ajrit në mjediset spitalore duhet të jetë:

- A) 60-65%
- B) 50-60%
- C) 30-50%
- D) 20-30%

23. Sa etapa ka procesi i kujdesit infermieror?

- A) 1
- B) 3
- C) 5
- D) 7

24. Mledhja e të dhënave nga komunikimi me familjarët dhe klientin është etapa:

- A) E parë e kujdesit infermieror
- B) E dytë e kujdesit infermieror
- C) E tretë e kujdesit infermieror
- D) E katërt e kujdesit infermieror

25. Në mbledhjen e të dhënave për përcaktimin e diagnozës infermiore nuk bën pjesë një nga elementët e mëposhtëm:

- A) Observimi
- B) Kartela e mjekut
- C) Biseda me klientin
- D) Planifikimi

26. Hemoragjia nga hundet quhet:

- A) Epistaksis
- B) Petekje
- C) Eritema
- D) Hipoksi

27. Ekzaminimi i një regjoni me anë të goditjes quhet:

- A) Palpacion
- B) Perkusion
- C) Askultacion
- D) Vibracion

28. Të dhënat subjektive janë të dhëna që sigurohen nga:

- A) Testet diagnostikuese
- B) Testet laboratorike
- C) Pacienti dhe familjarët
- D) Observimi

29. Komunikimi intrapersonal është komunikimi që ndodh brënda:

- A) Një individ
- B) Dy individëve
- C) Një grup individësh
- D) Publik

30. Në procesin e komunikimit dërguesi është personi i cili:

- A) Motivon një person për të komunikuar
- B) Mjedisi ku realizohet komunikimi
- C) Merr mesazhin
- D) Inicion komunikimin

31. Cila nga këto përgjigje nuk është e saktë. Mesazhet dërgohen me anë të një kanali komunikimi që janë të tipit:

- A) Auditiv
- B) Viziv
- C) Perceptues
- D) Prekës

32. Termometri për matjen e temperaturës trupore, mat temperaturën në intervalet:

- A) 37-45 °C
- B) 34-42.2 °C
- C) 30-41.2 °C
- D) 26-40 °C

33. Rritja e temperaturës trupore mbi normalen quhet:

- A) Hipotension
- B) Hypertension
- C) Hipotermi
- D) Hipertermi

34. Gjatë një hipotermie ndodh:

- A) Shtim i frekuencës urinare
- B) Shtim i frekuencës respiratore
- C) Ulje e frekuencës respiratore
- D) Konvulsione

35. Matja e pulsit apikalo-radial realizohet nga:

- A) 1 infermiere
- B) 2 infermiere
- C) 3 infermiere
- D) Vet pacienti

36. Administrimi topik i medikamenteve realizohet në rrugë:

- A) Orale
- B) Parenterale
- C) Nëpërmjet traktit respirator
- D) Nëpërmjet lëkurës dhe mukozave

37. Cila nga mënyrat e mëposhtëme të administrimit të medikamenteve nuk bën pjesë në administrimin parenteral?

- A) Intra/muskular
- B) Intra/venoz
- C) Sub/kutan
- D) Transdermal

38. Gjatë periudhës së ovulacionit femrat kanë një temperaturë më të lartë se normalja. Gjeni cila është përgjigja e saktë:

- A) 2 °C
- B) 1.5 °C
- C) 1 °C
- D) 0.6 °C

39. Kur një medikament duhet të qëndroj në stomak për efekt lokal pacienti pozicionohet?

- A) Djathtas
- B) Majtas
- C) Fowler
- D) Semi-fowler

40 Kur indi është i vogël ose kemi një age të gjatë injeksionet sub-kutane realizohen në kënd:

- A) 75 gradë
- B) 65 gradë
- C) 55 gradë
- D) 45 gradë

41. Injeksionet intra/muskulare nuk realizohen në muskulin:

- A) Gluteal
- B) Femoral
- C) Vastus-lateral
- D) Facial

42. Teknika zikzak e injektimit të medikamenteve realizohet në injeksionet:

- A) Intra/venoze
- B) Intra/muskulare
- C) Intra/dermale
- D) Sub/kutane

43. Metoda e administrimit të oksigjeno terapisë realizohet me anë të:

- A) Sondës nazo-gastrike
- B) Kateterit urinar
- C) Vigonit
- D) Kateterit nazal

44. Niveli i lartë i lengjëve në organizëm quhet:

- A) Hiperkalemi
- B) Hipokalemi
- C) Hipovolemi
- D) Hipervolemi



45. Sa përqind të peshës së përgjithshme trupore zë sasia totale e ujit në organizëm?  
A) 55-85%  
B) 45-75%  
C) 35-65%  
D) 25-55%
46. Cili nga këta element kimik ka një rol të rëndësishëm në formimin e skeletit të trupit?  
A) Na  
B) K  
C) Ca  
D) Mg
47. Cili nga këta element kimik ka një rol të rëndësishëm në acidozën dhe alkalozën metabolike?  
A) HPO<sub>4</sub>  
B) Cl  
C) Mg  
D) HCO<sub>3</sub>
48. Cili nga këto element nuk bën pjesë në makroelementët ushqimor?  
A) Uji  
B) Karboidratet  
C) Vitaminat  
D) Yndyrnat
49. Ulja e oreksit ose e dëshirës për të ngrënë quhet:  
A) Nauze  
B) Anoreksi  
C) Vomitus  
D) Flatulencë
50. Gjatë periudhës së dimrit proceset metabolike:  
A) Ulen  
B) Rriten  
C) Ndikohen nga gjinia  
D) Nuk ndryshojnë
51. Hapja kirurgjikale që bëhet në stomak nëpërmjet murit abdominal dhe shërben për ushqyerjen e pacienti quhet:  
A) Tonsilectomi  
B) Laringostomi  
C) Gastrostomi  
D) Faringostomi
52. Cila nga rrugët e mëposhtme nuk është një rrugë ushqyerje për pacientin?  
A) Parenterale  
B) Kateteri nazal  
C) Sonda nazo-gastrike  
D) Orale

53. Procesi i zbrazjes së vezikës urinare quhet:

- A) Meatus
- B) Uretër
- C) Miksion
- D) Sfinkter

54. Zbrazja e vezikës urinare tek adultët ndodh kur në veshkë janë grumbulluar:

- A) 50-150 ml/urinë
- B) 100-200 ml/urinë
- C) 150-250 ml/urinë
- D) 200-300 ml/urinë

55. Sasia e urinës që mbetet në vezikë pas urinimit quhet:

- A) Poliuri
- B) Anuri
- C) Oliguri
- D) Urinë reziduale

56. Prania e pusit në urinë quhet:

- A) Glukozuri
- B) Piuri
- C) Hematuri
- D) Dizuri

57. Urinimi i shpeshtë gjatë natës, vecanërisht kur nuk janë marrë sasi të mëdha lëngjesh quhet:

- A) Inkontinencë urinare
- B) Polakiuri
- C) Nikturi
- D) Piuri

58. Sa është sasia e solucionit që shërben për të fryrë balonin e kateterit foley gjatë procesit të kateterizimit urinar?

- A) 5 ml
- B) 10 ml
- C) 15 ml
- D) 20 ml

59. Cili nga medikamentet e mëposhtëm nuk është një anticoagulant?

- A) Heparina
- B) Acenocumaroli
- C) Varfarina
- D) Ampicilina

60. Hemokultura është një analizë gjaku:

- A) Biokimike
- B) Klinike
- C) Bakterologjike
- D) Parazitologjike

61. Prova që shërben për të matur sasinë e urinës gjatë 24 orëve quhet:

- A) Adissi
- B) Ziminski
- C) Urokulturë
- D) Glukozuri

62. Ekzaminimi bakterologjik i feçeve quhet:

- A) Hemokulturë
- B) Koprokulturë
- C) Urokulturë
- D) Parazitologjike

63. Në qëndrimin shtrirë në planin horizontal të pacientit, nuk bën pjesë:

- A) Dekubitus dorsal
- B) Dekubitus ventral
- C) Dekubitus lateral
- D) Pozicioni ortopne

64. Gjatë vendosjes së pacientit në pozicion semi-fowler shpina formon me shtratin një kënd:

- A) 90 gradë
- B) 60 gradë
- C) 45 gradë
- D) 25 gradë

65. Plagët që krijohen nga qëndrimi në shtrat për një kohë të gjatë ose nga presioni quhen:

- A) Ulçera sipërfaqësore
- B) Ulçera të thella
- C) Dekubitus
- D) Imobilitet

66. Cili ndër këta faktor ka më tepër ndikim në formimin e dekubitusëve?

- A) Anemia
- B) Lageshtia
- C) Vit. C
- D) Temperatura

67. Sa stade ka gjumi me lëvizje të shpeshta të syve GJ.L.SH.S?

- A) 0
- B) 2
- C) 4
- D) 6

68. Sa stade ka gjumi me lëvizje të ngadalta të syve GJ.L.N.S?

- A) 0
- B) 2
- C) 4
- D) 6

69. Paftësia për të bërë një gjumë cilësor quhet:

- A) Narkolepsi
- B) Insomnia
- C) Apnea e gjumit
- D) Somnabulizëm

70. Një valë e papritur mbingarkese gjumi që ndodh gjatë ditës quhet:

- A) Hipersomni
- B) Eneurezis
- C) Narkolepsi
- D) Somnabulizem

71. Paftësia e zotërimit të defekimit të feçeve dhe gazrave nga anusi quhet:

- A) Diarre
- B) Koprolite
- C) Konstipacion
- D) Inkontinencë fekale

72. Egzaminimi i një organi ose i një regjoni me anë të prekjes quhet:

- A) Askultacion
- B) Perkusion
- C) Palpacion
- D) Vibracion

73. Të dhënat objektive janë të dhëna që infermieri i merr nga:

- A) Pacienti
- B) Observimi
- C) Ekzaminimet diagnostikuese
- D) Testet laboratorike

74. Komunikimi intrapersonal ndodh:

- A) Brënda një individi
- B) Metakomunikimit
- C) Midis 2 individëve
- D) Publik

75. Në elementët e komunikimit verbal bën pjesë:

- A) Xhestet
- B) Zhurmat
- C) Humori
- D) Ecja

76. Matja e temperaturës orale nuk është e sigurtë:

- A) Te pacientët me diarre
- B) Te pacientët e djersitur
- C) Te pacientët me atake epileptike
- D) Te pacientët me konstipacion

77. Rritja e shpejtësisë së pulsit mbi 100 rrah/min quhet:

- A) Takipne

- B) Takikardi
- C) Bradipne
- D) Bradikardi

78. "Na" është një anion i cili merr pjesë në:

- A) Tkurrjen muskulare
- B) Metabolizmin e karbohidrateve
- C) Ruajtjen e ekulibrit acido-bazik
- D) Balancën hidrike

79. Në parimet e kujdesit shëndetësor bën pjesë:

- A) Autonomia
- B) Vërtetësia
- C) Besnikëria
- D) Besueshmëria

80. Sa përqind të peshës së përgjithshme trupore zë lengu brëndaqelizor?

- A) 5%
- B) 30%
- C) 50%
- D) 60%

81. Cila është sasia e oksigjenit që jepet me anë të kanjullës nazale?

- A) 1l/min
- B) 2-4l/min
- C) 5-7 l/min
- D) 6-8 l/min

82. Nga mëngjesi në darkë temperatura e trupit luan me?

- A) 0.1 °C
- B) 0.2 °C
- C) 0.3 °C
- D) 0.4 °C

83. Ulja e shpejtësisë së pulsit nën 60 rrah/min quhet:

- A) Takipne
- B) Takikardi
- C) Bradipne
- D) Bradikardi

84. Cili nga këta muskuj është më i përdorshmi për bërjen e injeksioneve i/m?

- A) Ventro gluteal
- B) Vastus lateral
- C) Deltoid
- D) Femoral

85. Në rregullat e kujdesit shëndetësor bën pjesë:

- A) Drejtësia
- B) Vërtetësia
- C) Jokeqdashje

D) Bamirësia

86. Lidershipi drejtues:

- A) Nuk përfshin ndjekësit e tij në zgjidhjen e problemeve
- B) Është lider demokratik
- C) Përfshin ndjekësit e tij në dhënien e ideve
- D) Jep ide të reja

87. Në faktorët e brëndshëm që ndikojë në sëmundje bën pjesë:

- A) Shtrirja e simptomave
- B) Shoqëria
- C) Faktorët. ekonomik
- D) Niveli kulturor

88. Parandalimi dytësor konsiston:

- A) Programet e edukimit shëndetësor
- B) Imunizimin e efekteve të sëmundjes
- C) Trajtimin dhe izolimin e sëmundjes
- D) Diagnostikimin e sëmundjes

89. Cila është temperatura që duhet të ruhet në ambientet spitalore?

- A) 21-26 gradë celcius
- B) 22-27 gradë celcius
- C) 26-28 gradë celcius
- D) 20-22 gradë celcius

90. Diagnoza mjeksore është:

- A) E drejtuar nga patologjia dhe zgjat aq kohë sa zgjat sëmundja.
- B) Përkthyer në përgjigjen e personave për sëmundjen.
- C) Trajton të sëmurin
- D) Identifikon një simptom të caktuar.

91. Në elementët e komunikimit joverbal bën pjesë:

- A) Shprehjet e fytyres
- B) Ritmi
- C) Fjalori
- D) Humori

92. Zona personale është:

- A) 4 inç-18fit
- B) 4 inç-12fit
- C) 12 inç-4fit
- D) 18 inç-4fit

93. Matja e temperaturës rektale nuk është e sigurtë te:

- A) Pacientët me episode krizash.
- B) Pacientët që kanë bërë ndërhyrje në zonën rektale.
- C) Pacientët me të vjella.
- D) Pacientët me konstipacion

94. Sa përqind të peshës së përgjithshme trupore zë lengu intersticial?  
A) 5 %  
B) 10 %  
C) 15 %  
D) 20 %
95. Sa përqind të oksigjenit në gjak transporton Hg?  
A) 90 %  
B) 93 %  
C) 97 %  
D) 99 %
96. Ne qofte se një infermiere përvetëson sendet personale të një pacienti ajo ka thyer:  
A) Kodin etik  
B) Ligjin  
C) Deontologjinë  
D) Vlerat
97. Njollat e kuqe, të mëdha të ngritura mbi nivelin e lëkures që shpesh janë të dhimbshme quhen:  
A) Petekje  
B) Eritema  
C) Epistaksis  
D) Egzentema
98. Diagnoza infermierore është:  
A) E njëjtë nga një person tek një tjetër.  
B) Ndryshon nga një person tek një tjetër  
C) Drejtohet nga patologjia  
D) Zgjat aq kohë sa zgjat sëmundja.
99. Distanca që aplikohet në zonën sociale është:  
A) 1-12 fit  
B) 2-12 fit  
C) 3-12 fit  
D) 4-12 fit
100. Pasi jepen medikamentet me anë të tubit nazogastrik pacienti vendoset në pozicion:  
A) Shtrirë nga e majta  
B) Shtrirë nga e djathta  
C) Semi-fowler  
D) Fowler
101. Ca është një kation i cili merr pjesë në këte funksion:  
A) Transmetimin e impulseve nervore  
B) Transmetimin e impulseve elektrike  
C) Nxiti aktivitetin e enzimave  
D) Nxiti aktivitetin e karbohidrateve

102. Procesi i hapjes se uretres quhet:

- A) Meatus
- B) Miksion
- C) Polakiuri
- D) Poliuri

103. Paaftësia për të kontrolluar shkarkimin e urinës nga vezika urinare quhet:

- A) Oliguri
- B) Retesion urinar
- C) Inkontinencë urinare
- D) Anuri

104. Pamundësia për të qëndruar në gjumë për shkak të zgjimeve të shpeshta quhet insomni:

- A) fillestare
- B) Sekondare
- C) Terminale
- D) Intermitente

105. Neonati(i porsalinduri 0-3muaj) fle:

- A) 10-12orë në ditë
- B) 12-14orë në ditë
- C) 14-16orë në ditë
- D) 16-20orë në ditë

106. Infeksionet që ndodhin nga kateterizimi i vezikës mund të shkaktohen nga faktorët:

- A) Mosdezifektimi i mirë i zonës përreth uretrës.
- B) Mos futja siç duhet e kateterit
- C) Mos larja e duarve të pacientit
- D) Mos funksionimi siç duhet i uretrës

107. Rritja e hematokritit tregon:

- A) Anemi
- B) Infeksion
- C) Trashje të gjakut
- D) Hollim të gjakut

108. Cili nga tre qëllimet kryesore të elementëve ushqimor është i gabuar?

- A) Formojnë strukturën trupore (kockë, gjak)
- B) Sigurojnë energji e cila matet me kilokalori
- C) Formojnë pjesën muskulare të një organi.
- D) Ndhimojnë rregullimin e reaksioneve kimike

109. Gjatë stadi të IV të gjumit me lëvizje jo të shpejta të syve shpejtësia e rrahjeve të zemrës dhe të respiracioneve ulet:

- A) 10-19 %
- B) 20-30 %
- C) 31-40 %
- D) 41-50 %



110. Ecja në gjumë quhet:

- A) Insomni
- B) Hipersomni
- C) Parasomni
- D) Somnabulizëm

111. Cili është raporti antikoagulant /gjak që duhet për marrjen e një analize?

- A) 0.3ml/5ml
- B) 0.5ml/3ml
- C) 0.5-0.3ml
- D) 0.5ml/5ml

112. Metodatat për kontrollimin e tubit nazogastrik:

- A) Tubi futet me ane të gastrostomise
- B) Tubi futet me anë të një incizioni
- C) Fut me anë të shiringës pak ajër në fund të tubit
- D) Fut me anë të shiringës pak gjak në fund të tubit

113. Rritja e nivelit të troponines është tregues i:

- A) Infarkt të miokardit
- B) Hepatitit
- C) Nefropatise
- D) Otitit

114. Cila nga këto prova shërben për të matur dendësinë e urinës?

- A) CPK
- B) Adissi
- C) Ziminski
- D) CPR

115. Gastrostomia konsiston në:

- A) Observimin e organeve të sipërme digjестive
- B) Futjen e një tubi në stomak me anë të një ndërhyrje kirurgjikale
82. Infermierja po merr anamnezën e znj. X gjatë vizitës së parë prenatale kur gruaja rezulton 10 javë me barrë. Cila prej pikave të mëposhtme tregon që znj. X është në rrezik për zhvillimin e diabetit gestacional gjatë kësaj barre?

- A) Ajo është 28 vjeçe
- B) Fëmija i parë i saj ka lindur me seksio
- C) Në anamnezën familjare rezulton diabet i tipit të I-rë
- D) Pesha e fëmijës së fundit në lindje ka qënë 4530gr.

83. Konsultimi para konceptimit është i rëndësishëm për përfundimin e shtatzanisë tek gruaja me diabet, për shkak se kontrolli i dobët i glicemisë para dhe në periudhën e hershme të barrës shoqërohet me:

- A) Anomali kongenetale të fetusit
- B) Episode të shpeshta të hypoglicemisë amtare
- C) Hyperemesis gravidarum
- D) Polihydramion

84. Gjatë vizitës prenatale infermierja i shpjegon dietën Znj. X me diabet pregestacional. Infermierja vleron që instruksioni i saj ka qënë efektiv, kur zonja X thotë:

- A) Dieta dhe insulina duhet të ndryshojë gjatë barrës
- B) Unë do të planifikoj dietën në bazë të nivelit të glukozës
- C) Unë do të vazhdoj me të njëjtën dietë si përpara barrës, për aq kohë sa ajo do të jetë e mirë balancuar
- D) Unë do të jetë e nevojshme të marrë më shumë se 600 kalori në ditë që nga momenti që jam shtatzanë

85. Një grua paraqitet në departamentin e urgjencës duke ankuar për gjakrrjedhje dhe crampe. Fillimisht infermierja i merr anamnezën për menset e fundit, të cilat ajo i kishte patur 6 javë më parë. Me një speculum steril ekzaminohet me kujdes dhe shihet që columi është i mbyllur. Plani i kujdesit në këtë grua do të bazohet në diagnozën e cilit tip të abortit?

- A) I paevitueshëm
- B) Incomplet
- C) Rrezik aborti
- D) Septik

86. Znj. D. është 13 jave shtatzanë. Ajo ankon për dhimbje në fund të barkut dhe hemoragji. Gjatë ekzaminimit vaginal, mjeku konstaton se gruaja ka shkurtim të qafës së mitrës dhe dilatacion të saj. Cili lloj aborti është ky:

- A) Abort progredient
- B) Abort i komplet
- C) Mised abort
- D) Rrezik aborti

87. Gruaja është në javën e tete të shtatzanisë. Gjatë ekzaminimit me ultrasaund mjeku nuk arrin të kapë RZF. Në këtë rast kemi të bëjmë me:

- A) Abort habitual
- B) Abort i komplet
- C) Abort të paevitueshëm
- D) Missed abort

88. Një grua 10 javë shtatzanë merr në telefon shërbimin prenatal dhe i referon se ajo ka hemoragji vaginale. Cila duhet të jetë përgjigjia fillestare e infermieres:

- A) Ndoshta ju keni abortuar. Sill me vete të gjitha garzat apo lineset dhe hajde në klinikë tani.
- B) Përshkruaj sasinë e hemoragjisë, karakteristikat dhe kohën e gjakrrjedhjes (sa kohë ka zgjatur hemoragjia)
- C) Të rrijë regjim shtrati dhe nëse hemoragjia vazhdon të lajmërojë menjëherë
- D) Të vijë në klinikë sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim që të vizitohet

89. Një grua gravide 8 javëshe paraqet rrezik aborti. Kush është trajtimi i duhur për këtë lloj aborti:

- A) Përgatitja e gruas për t'ju bërë dilatacionin e kyretazhi
- B) Vendosja e gruas regjim shtrati për disa ditë dhe rivlerësimi i saj
- C) Përgatitja e gruas për ekzaminim ekografik për të parë integritetin e sakusit gestacional
- D) Qetësimi i gruas duke i treguar asaj që edhe n.q.se e humbet këtë fëmijë ajo mund të ngelet përsëri shtatzane pas një muaji.

90. Manifestimi klinik i placenta previas që e dallon nga distako placenta është prezenca e:

- A) Aktivitetit uterin
- B) Crampeve
- C) Dhimbjes
- D) Hemoragjisë

91. Gjatë aplikimit të forcepsit infermiere-mamia duhet:

- A) Të ndjehet R.Z.F.
- B) Të ndjehet T.A.
- C) Të vlersojë pulsën amtar
- D) Të vlersojë T°

92. Kur vendoset forcepsi dilatacionin duhet të jetë:

- A) 6 - 7 cm
- B) 7 - 8 cm
- C) 10 cm
- D) Mbi 10 cm

93. Polihydramion kemi kur sasia e likidit amniotic është:

- A) 1000 ml
- B) 500 ml
- C) 1500 ml
- D) Mbi 2000 ml

94. Nëse gruaja ka një lindje në javën e 41 të shtatzanisë së saj, efarë lloj lindje ajo duhet të konsiderohet:

- A) Pretermë
- B) Termë
- C) Postermë
- D) Gestacinale

95. Nëse gruaja ka një lindje në javën e 38 të shtatzanisë së saj, efarë lloj lindje ajo duhet të konsiderohet:

- A) Pretermë
- B) Termë
- C) Postermë
- D) Gestacinale

96. Nëse gruaja ka një lindje para javës së 36 të shtatzanisë së saj, efarë lloj lindje ajo duhet të konsiderohet:

- A) Pretermë
- B) Termë
- C) Postermë
- D) Gestacinale

97. Shtatzania e zonjës x kalon kufirin e 42 j. Në këtë situatë mamia mendon se fetusi i kësaj zonje është i rrezikuar për:

- A) Makrosomi
- B) Malprezentacion
- C) Polihydramion
- D) Sepsis fetal

98. Shënja që një grua shtatzane ka aktivitet të parakohshëm lindje mund të jetë:

- A) Dhimbja që shoqëron kontraksionet uterine është e fortë, konstante dhe lokalizohet në pjesën e sipërme të barkut, në fundusin uterin
- B) Kontraksionet uterine zgjasin të paktën 20 minuta
- C) Kontraktime uterine të cilat ndodhin me një frekuencë prej katër kontraksionesh në 1 orë
- D) Shkurtimi qafës së mitrës deri në 80% edhe dilatacioni 2 cm.

99. Një grua shtatzanë, në javën e 32 të shtatzanisë është përcaktuar të jetë me rrisht për lindje pretermë. Një shenjë, që të ndodhë lindja pretermë do të jetë:

- A) Dhimbja që shoqëron kontraksionet uterine është e fortë dhe konstate
- B) Dilatacioni cervikal është më shumë se 1 cm
- C) Kontraksionet uterine i kemi me një frekuencë, 4 kontraksione në një orë
- D) Përgatitja e qafës mitrës (zbutaja) dhe shkurtimi i saj 25%

100. Një grua e hospitalizuar për aktivitet të parakohshëm po merr MgSO<sub>4</sub> i/v. Rezultati i pritshëm për këtë trajtim do të jetë n.q.s:

- A) Ataket eklamptike nuk do të ndodhin
- B) Kontraksionet uterine ndalohen
- C) Mushkrittë e të porsalindurit fillojnë prodhojnë surfaktant
- D) Nuk ndodh plasja e parakohshme e membranave

101. Mamia duhet të kryej testin nitrazinës për të:

- A) Përcaktuar nëse gjaku është prezent në likidin amniotik
- B) Dalluar likidin amniotik nga urina duke testuar pH
- C) Bërë ndryshimin mes feeeve maternale dhe meconiumit
- D) Përcaktuar veeoritë e gravitetit të uterusit

102. Zonja X është 23 javë shtatzanë. Ajo ju telefonon dhe ju thotë se mendon që ka rrjedhje të ujrave nga vagina.ju do ti thoni asaj:

- A) Hajdeni menjëherë në klinikë
- B) Më telefono pas 2 h dhe më trego nëse ka ndryshime të rrjedhjeve
- C) Ne mund të presim deri në vizitën tjetër të radhës
- D) Për sa kohë që bebi lëviz ju mos u shqetësoni

103. Kur gruas i plasin membranat amniotike parakohe mamia duhet të vlersojë T° çdo:

- A) 1 orë
- B) 4 orë
- C) 6 orë
- D) 8 orë

104. Gruaja paraqitet në klinikë dhe ankon për dhimbje (kontraksione). Mamia mendon për aktivitet të parakohshëm atëherë kur:

- A) kontraksionet janë çdo 30 min dhe zgjasin 90 sek
- B) Kontraksionet janë çdo 5 min dhe zgjasin 30 sek
- C) Kontraksionet janë të çrregullta në intervale të ndryshme kohore
- D) Kontraksionet janë të çrregullta, por të forta

105. Znj x është 36 javë shtatzanë. Ajo referon se ka dhimbje shpine, si dhe dhimbje me forcim të barkut. Infermiera në këtë rast vlerson kontraksionet uterine për rreth:

- A) 5 min
- B) 10 min
- C) 15 min
- D) 30 min

106. Pozicioni më i pershtatshëm që ju i rekomandoni gruas shtatzanë pas plasjes së membranave është në:

- A) Dekupitus dorsal
- B) Dekupitus lateral dextra
- C) Dekupitus lateral sinistra
- D) Pozicioni drejt qëndrim

107. Kur infermiere mamia bën planifikimin e kujdesit për gruan të cilës i kanë plasur membranat amniotice, ajo arsyeton që gruaa është e rriskuar për:

- A) Hemoragji
- B) Hypotension në pozicion shtrirë me shpinë
- C) Infeksion intrauterine

D) Lindje precipitoze

108. Menjëherë pas lindjes, gjatë vlersimit që infermiera i bën gruas vë re që fundusi uterin është i squllur dhe ka gjakrrjedhje të madhe. Etiologjia më e mundëshme e kësaj gjakrrjedhje është:

- A) Atonia e uterusit
- B) Hematoma vaginale
- C) Inversioni uterin
- D) Laceracioni vaginal

109. Hemoragjitë e vona të post partumit shkaktohen nga:

- A) Atonia uterine
- B) Mbetjet e fragmenteve placentare
- C) Multipariteti i madh
- D) Zgjatje e aktivitetit të lindjes

110. Pas lindjes, gjatë ekzaminimit të zonjës X ju konstatooni se brënda 15 min linesi i saj arrin të saturohet plotësisht. Veprimi i parë infermier që ju ndërmerni është:

- A) Kontrolloni shënjat vitale
- B) Lajmëroni mjekun
- C) Palponi fundusin uterin
- D) Rrisni marrjen e likideve i/v

111. Zonja X është 25 vjeç. Ajo ka 2 gravidanca, dhe 2 lindje, njëren prej të cilave e pati para 4 orësh ku lindi një fëmije mashkull me peshë 4150gr induktimi i kësaj lindje u bë me oxytocinë. Gruaja vendos të lajmërojë menjëherë infermierën pasi ka shumë gjakrrjedhje. Shkaku i mundshëm i një postpartumi hemoragjik në këtë kliente mund të jetë:

- A) Atonia uterine
- B) Infeksioni puerperal
- C) Laceracion vaginal i pariparuar
- D) Mbetje të fragmenteve placentare

112. Pas lindjes gruaja ka hemoragji të vazhdueshme në sasi të pakët, fundusi uterin i kontraktuar. Kjo vjen si pasojë:

- A) Atonisë së uterusit
- B) Laceracionit të columit
- C) Mbetjeve të fragmenteve placentare
- D) Mbetjeve të membranave amniotike

113. Hemoragjia e hershme e postpartumit (hemoragjia që ndodh brenda 24 orëve të para të pas lindjes) ka më pak gjasa të ndodhë si rezultat i:

- A) Atonin uterine
- B) Formacioneve të hematomave
- C) Laceracionet e labieve, perineumit, vaginës ose cerviksit
- D) Subinvolucionin e uterusit

114. Shkaqet më të shpeshta të subinvolucionit janë:

- A) Barra multiple dhe hemorragjia postpartum
- B) Hemoragjia postpartum dhe infeksioni
- C) Kontraksion persistent dhe mbidozim me oxytocinë

D) Mbetje e fragmenteve placentare dhe infeksioni

115. Katër orë pas një aktiviteti dhe lindje të vështirë, një grua primipare refuzon të ushqejë beben e saj. Ajo është gjithashtu e lodhur dhe nuk dëshiron të flejë. Mamia duhet:

- A) Ta vlersoje si një lodhje e një faze të vështirë
- B) Ta rregjistroje si qëndrim joefektiv i ndërlydhjes nënë - fëmijë
- C) Ti thotë gruas që ajo mund të pushojë pasi ushqen beben e saj
- D) Të ktheje bebin në infermieri, duke siguruar gruan që pushimi i saj është prioritet në këtë fazë

116. Gratë në postpartum përjetojnë rrisht të lartë për infeksion të traktit urinar. Për të prevenuar këto infeksione mamia duhet t'u mësojë grave në postpartum që:

- A) Aciditeti i urinës kalon duke pirë 3 gota lëng portokalli edo ditë
- B) Kryerja e një kujdesi perineal sistematik duke zbatuar parimet bazë
- C) Të boshatisë vezikën edo 4 orë gjatë gjithë ditës
- D) Të vazhdojë të marrë likide 1-2 litra cdo ditë

117. Një grua shtatzanë për herë të parë lind dy binjakë në javën e 37 të shtatzanisë. Përshkrimi korrekt i anamnezës obstetrikale të gruas do të jetë:

- A) Multigravida, multipara
- B) Multigravida, primipara
- C) Primigravida, multipara
- D) Primigravida, primipara

118. Barra binjake shpesh:

- A) Kalon ditën e lindjes
- B) Con ne lindje premature
- C) Nuk e ka të parashikueshme kohën e lindjes
- D) Shkon deri në term

119. Shtimi në peshë i pritshëm për gruan shtatzanë me binjakë është:

- A) Më pak se të kishte një fetus
- B) Më shume se të kishte një fetus
- C) Varet se sa janë zhvilluar fetuset
- D) Është e njëjtë si të kishte një fetus

120. Për të prevenuar komplikacionet shumë specialistë rekomandojnë regjimin e shtratit për barrat binjake të fillojë në:

- A) 16 javë të shtatzanisë
- B) 20 javë të shtatzanisë
- C) 28 javë të shtatzanisë
- D) 30 javë të shtatzanisë

121. Bradikardia fetale është më shumë e zakonshme gjatë:

- A) Administratimit tokolitik
- B) Anemisë fetale
- C) Infeksionit intraamniotik
- D) Zgjatjes së kompresionit të cordonit umbilical

122. Takikardia fetale është më shumë e zakonshme gjatë:



- A) Administratimit me MgSO<sub>4</sub>
- B) Anestezisë regionale
- C) temperatura maternale
- D) Prolapsit të kordonit umbilikal

123. Infermiera duhet të assistojë lindjen në pozicionin këmbë - duar kur:

- A) Ka prolaps të kordonit
- B) Membranat janë rupturuar
- C) Oxyputi i fetusit është në pozicionin anterior
- D) Prezentacioni i fetusit është me podiume

124. Në pranim të obstetrikës vjen një grua me dhimbje shumë të forta barku. Gjatë vlerësimit që bën mamia vë re se gruaja pavarësisht dhimbjeve nuk ka kontraksione uterine. Ajo është shumë e zbehtë, ka puls të përshpejtuar, si dhe hemoragji të pakët vaginale. Në këtë rast mamia menjëherë dyshon për:

- A) Distako placentë
- B) Distoci uterine
- C) Placenta previa
- D) Rupturë të uterusit

125. Disfunksioni uterin hipertonic zakonisht ndodh në fazën:

- A) Aktive
- B) E expulsionit
- C) E tranzicionit
- D) Latente

126. Cila nga vlersimet e mëposhtme nuk është e lidhur me prezentacionin me podiume?

- A) Prania e mekoniumit në likidin amniotik
- B) Lindja parakohe e femijes
- C) Degjimi RZF kuadratin e jashtëm abdominal
- D) Kalimi i dates se parashikuar të lindjes

127. Znj. E. ka shtatzaninë e saj të parë. Ajo ka një aktivitet lindje prej 15 orësh. Dy orë përpara në ekzaminimin vaginal shihet se cerviksi është dilatuar 5cm dhe columi është zhdukur plotësisht, pjesa prezantuese është në stacionin 0. Në vizitën vaginale të kryer pas 2 orësh vihet re se nuk ka ndryshime. Cili model i aktivitetit anormal është i lidhur me këtë përshkrim?

- A) Arrest i fazës aktive
- B) Fazë aktive e zgjatur
- C) Zbritje e zgjatur
- D) Zgjatja e fazës latent

128. Kur vlerësohet një grua për diskomfort menopauzal, diskomforti i raportuar më shpesh është:

- A) Afshet e nxehta
- B) Dhimbja e kokës
- C) Ndryshim i humorit
- D) Thatësia e vaginës

129. Cila nga pikat e mëposhtme është faktor rrishtës për osteoporosis?

- A) Marrja e pakët e proteinave

- B) Obeziteti
- C) Raca
- D) Trup i dobët

130. Një grua ankon për dhimbje të forta barku e pelvike rreth periudhës së zakoneve, e cila e ka përkeqsuar gjendjen e saj në 5 vitet e fundit. Ajo gjithashtu ankon për dhimbje gjatë mardhënieve seksuale dhe është përpjekur që të ngelet shtatzanë 18 muajt e fundit por pa sukses. Këto simptoma kanë më tepër mundësi të lidhen me:

- A) Dismenorrenë primare
- B) Dismenorrenë sekondare
- C) Endometriozen
- D) Sindromi premenstrual

131. Kur një femer consultohet për dismenorrhea primare, cilat nga ndërhyrjet e më poshtme jo farmakologjike do të përdoret?

- A) Mos bërja e ushtrimeve gjatë periudhës menstruale
- B) Përdorimi i kompresave të ngrohta për të lehtësuar crampet
- C) Shmagia e mardhënieve seksuale gjatë ditës së parë të menseve
- D) Shmangia e cafeinës gjatë periudhes menstruale

132. Me amenorre kuptojmë:

- A) Fluks i pakët menstrual
- B) Fluks i shtuar menstrual
- C) Menstruacione të dhimbshme
- D) Mungesë e menseve

133. Dhimbja e fortë, akute jo menstruale lidhet me:

- A) Cisti ovarial i rupturuar
- B) Dismenorreanë primare
- C) Dispozitivin Intra- Uterin
- D) Sëmundjet malinje të ovareve

134. Dhimbja menstruale rekurente dhe në mënyrë periodike lidhet me:

- A) Cistet ovariale
- B) Dismenorreha (primare, sekondare)
- C) Sëmundjet inflamatore pelvike akute
- D) Sëmundjet malinje të uterusit

135. Gjatë intervistës me një zonjë 31 vjeçare, mamia përpara ekzaminimit rutinë, mbledh të dhëna rreth ciklit të fundit menstrual. Ajo duhet të mbledhë informacion shtesë, në rastin kur gruaja përkrahet:

- A) rrjedhje shumë të shtuara
- B) sasi të vogël spottingu mes periodave
- C) Gjatësinë e ciklit menstrual nga 26 deri 29 ditë
- D) Rrjedhje menstruale më pak se 5-6 ditë

136. Në terapinë me estrogen të grave, ju do të përfshini rrezikun ndaj këtij trajtimi për:

- A) Cancer cervikal
- B) Cancer endometrial
- C) Cancer ovarian

D) Osteoporozis

137. Znj. X është diagnostikuar me fibromiom uterin. Kur bëhet plani i kujdesit infermierja duhet të dijë që:

- A) Janë fibromiome tumore malinje të uterusit
- B) Rriten fibromiome zakonisht mbas menopauzës
- C) Rritja e fluksit menstrual është një simptomë e zakonshme
- D) Barra mund të ndodhë në uteruset me fibromion

138. Amenorrea hypogonadotropike nuk shkaktohet nga:

- A) Humbje e shpejtë e peshës
- B) Kontraceptivet oralë
- C) Stresi
- D) Ushtrime të forta

139. Cila prej simptomave të mëposhtme të përshkruara nga një grua është karakteristike për sindromin premenstrual (SPM)?

- A) Unë filloj të kem fryrje barku dhe dhimbje gjoksi kur më fillojnë zakonet
- B) Unë kam dhimbje të forta të barkut rreth ditës së tretë të zakoneve
- C) Unë kam nauze, dhimbje koke pas fillimit të zakoneve
- D) Unë ndjehem e irrituar 1 javë -10 ditë para fillimit të menstruacioneve

140. Zonja X është 29 vjeç. Ajo ka qënë e diagnostikuar për lindje preterme, e cila u mbajt nën kontroll me preparate tokolitikë. Zonja kërkon të dijë kur ajo do të jetë në gjendje të shkojë në shtëpi:

- A) Pasi bebi të lindë
- B) Nëse i sigurohet një infermiere për ta kontrolluar
- C) Varet nga shtrimet në spital
- D) Edo kohë që ajo vetë të vendosë

141. Uterusi është një organ muskular në formë dardhe që përgjigjet për:

- A) Ciklin menstrual
- B) Prodhimin e hormoneve seksuale
- C) Fertilizimin
- D) Zgjimin seksual

142. Për arsye të efekteve të ciklit ovarian në ndryshimet e gjirit, koha më e mirë për të bërë vet-ekzaminimin e gjirit është:

- A) 5 - 7 ditë pas përfundimit të menseve
- B) Ditën e parë të ciklit endometrial
- C) Në mes të ciklit menstrual
- D) Edo kohë është e përshtatshme

143. Volumi i likidit amniotic është një faktor i rëndësishëm në vlersimin të mirëqënies fetale. Oligohydramioni ( më pak se 300 ml likid amniotic) lidhet me cilën nga anomalitë fetale:

- A) Renale
- B) Kardiake
- C) Gastrointestinale
- D) Neurologjike

144. Mensturacioni është gjakrrjedhje uterine periodike:

- A) Që ndodh edo 28 ditë
- B) Në të cilën bie shtresa e brendshme e uterusit
- C) Që rregullohet prej hormoneve ovarialë
- D) E cila drejton fertilizimin

145. Për të planifikuar familjen çifti vendos të përdorë metodën natyrore. E rëndësishme për ta është të dinë sa është jetëgjatësia e vezës pas ovulacionit. Mami vëre se mësimdhënia e saj ka qënë efektive kur eifti përgjigjet se jetëgjatësia e vezës është:

- A) 1 - 3 ditë
- B) 3 - 5 ditë
- C) 5 - 7 ditë
- D) 7 - 9 ditë

146. Gjatë instruksionit në lidhje me nivelet e dëshiruara të glukozës kur flitet për diabet gestacional, infermierja shpjegon nivelet e glukozës si p.sh. para ushqimit të cilat janë:

- A) 60-90 mg/dl
- B) 90-120 mg/dl
- C) 110-150 mg/dl
- D) 150-180 mg/dl

147. Znj x është 3 muajshe me barrë. Në vizitën e saj prenatale, ajo i thotë mami se nuk e kupton se çfarë po i ndodh: një minutë ajo është e lumtur që është shtatzanë dhe minutin tjetër ajo qan pa arsye. Cila prej përgjigjeve të mëposhtme të dhëna nga mami është më e përshtatshme?

- A) Është e zakonshme të kesh ndryshime të shpejta emocionale gjatë shtatzanisë
- B) Ju keni biseduar me partnerin tuaj rreth këtij problemi?
- C) Ju vertetë nuk e dëshironi këtë shtatzani?
- D) Mos u shqetëso ju do të ndjeheni më mirë brënda muajit

## 6. Neonatologji (Pediatri)

1. Transpozicioni i vazave te medha nenkupton:

- A) komunikim ndermjet atriumeve
- B) komunikim ndemjet ventrikujve
- C) aorta qe del nga ventrikuli i djathte
- D) ventrikul unik

2. Cili quhet femije premature?

- A) ai qe lind <37 jave moshe barre
- B) ai qe lind >42 jave moshe barre
- C) ai qe lind =20 jave moshe barre
- D) Ai qe lind midis 37-41 jave moshe barre

3. Ikteri fiziologjik shfaqet:

- A) ditën e pare te jetes
- B) ditën e trete te jetes
- C) ditën e dhjete te jetes
- D) muajin e pare te jetës

4. Ikteri nga papjtueshmeria e rhezusit shfaqet:
- A) ditën e parë të jetës
  - B) ditën e tretë të jetës
  - C) ditën e dhjetë të jetës
  - D) muajin e parë të jetës
5. Kernikter ose ikteri nuklear prek:
- A) aparatën gastro-intestinal
  - B) aparatën lokomotor
  - C) berthamat nukleare të trurit
  - D) aparatën kardio-respirator
6. Neonati nuk vendoset në gjë kur nëna është e sëmurë nga:
- A) rubeola
  - B) meningiti
  - C) HIV-Aids
  - D) tetanozi
7. Oftalmi është shenja më e zakonshme dhe më e shpëshhtë e:
- A) tetanozit
  - B) gonorese
  - C) sifilizit
  - D) rubeoles
8. Kush nga detreset e mëposhtme nuk quhet "detres kirurgjikal"?
- A) hernia diafragmale
  - B) sëmundja e membranave hialine
  - C) atrezia e koanave
  - D) atrezia e ezofagut
9. Ventrikuli unik ben pjesë në:
- A) kardiopati cianogjene
  - B) kardiopati jocianogjene
  - C) Kardiopati komplekse
  - D) Tetrada Fallo
10. Apgari nuk vlerësohet nëpërmjet:
- A) ngjyres së lekures
  - B) frekuencës respiratore
  - C) frekuencës kardiake
  - D) thithje-gëlltimit
11. Përbëjnë kundërrindikacion absolut për ushqyerjen me gjë të gjitha me përjashtim të:
- A) HIV në nënë
  - B) Insuficiencë kardiake e dekompenzuar e nënës
  - C) TBC aktiv në nënë
  - D) ragadet e gjirit të nënës
12. Pikezimi i Apgarit është:
- A) sëmundje ngjyresore e neonatit

- B) keqformim i lindur
- C) sëmundje e sistemit kardiorespirator
- D) sistem vlerësues i shenjave jetësore të neonatit

13. Ushqyerja ekskluzive me gji duhet te vazhdohet:

- A) dy muaj pas lindjes
- B) kater muaj pas lindjes
- C) gjashte muaj pas lindjes
- D) deri ne vitin e pare te jetes

14. Ne sallën e lindjes veprimi qe duhet bere gjithmone është:

- A) vendos bebin mbi barkun e nenes
- B) largoje ne nje dhome me vete
- C) mbaje larg nga ambjenti ku rri nena
- D) mos I jep informacion nenes

15. Ne sallën e lindjes ekipi neonator duhet te njoftohet:

- A) 30 minuta para lindjes
- B) ne momentin e lindjes
- C) pas lindjes
- D) nuk është e nevojshme te jene ne salle

16. Cila nga ekzaminimet e meposhtme laboratorike na tregon per nivelin e ikterit?

- A) bilirubinemia
- B) azotemia
- C) glicemia
- D) sediment

17. Bebi i porsalindur vendoset ne gji:

- A) menjehere pas lindjes
- B) ditën e pare pas lindjes
- C) tre ditet e par ate lindjes
- D) javën e pare pas lindjes

18. Pikezimi i Apgarit kryhet:

- A) ne minute e pare te jetes
- B) ne minute 0 te jetes
- C) 30 minutat e para
- D) ditën e pare te lindjes

19. Dhëmbët e qumështit zëvendësohen me dhëmbët e përhershëm:

- A) Rreth moshës 3-4 vjeç
- B) Rreth moshës 4-5 vjeç
- C) Rreth moshës 6-7 vjeç
- D) Rreth moshës 8-9 vjeç

20. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në rritje e zhvillim janë të gjithë me përjashtim të:

- A) Kushtet social-ekonomike
- B) Klima tropikale
- C) Sëmundjet kronike pas lindjes

D) Faktorët gjenetikë

21. Fëmija e dyfishon peshën e lindjes në moshën:

- A) 1 vjeç
- B) 8 muaj
- C) 10 muaj
- D) 5 muaj

22. Vitamina D merr pjesë në:

- A) mineralizimin e kockës
- B) aktivitetin nervor
- C) pjekurinë seksuale
- D) ematopoezë

23. Fëmija e trefishon peshën e tij në moshën:

- A) 8 muaj
- B) 1.5 vjeç
- C) 2 vjeç
- D) 12 muaj

24. Ikteri i të porsalindurit mund të jetë:

- A) Ikter nga infeksioni
- B) Ikter hemolitik
- C) Ikter fiziologjik
- D) Mund t'i ketë të gjitha origjinat

25. Gjatësia e fëmijës në lindje është rreth:

- A) 50 cm
- B) 40 cm
- C) 30 cm
- D) 60 cm

26. Faktorët e brendshëm që ndikojnë në rritje e zhvillim janë të gjithë me përjashtim të:

- A) hormoneve seksuale
- B) kushteve social-ekonomike
- C) hormoneve e tiroides
- D) hormoni somatotrop

27. Encefalopatia bilirubinike tek një fëmijë në term shfaqet kur vlera e bilirubinës serike arrin në:

- A)  $\geq 18$  mg/dl
- B)  $\geq 10$  mg/dl
- C)  $\geq 15$  mg/dl
- D)  $\geq 20$  mg/dl

28. Infeksioni neonatal nuk ka të vërtetë:

- A) hipotermi
- B) hipoglicemi
- C) hipobilirubinemi
- D) ulje të frekuencës kardiake

29. Vlerësimi i Apgarit nuk përfshin:

- A) frekuencën kardiake
- B) tonusin muskular
- C) frekuencën respiratore
- D) reflekset primare

30. Shkaktojnë keqformime të lindura të gjitha, me përjashtim të:

- A) rubeola kongenitale
- B) toksoplazmoza kongenitale
- C) CMV kongenital
- D) hepatiti B kongenital

31. Mund të jenë shenja klinike të një infeksioni neonatal të gjitha, me përjashtim të:

- A) hipotermi
- B) hiperglicemi
- C) hepatosplenomegali
- D) bombim i fontanelës

32. Kern ikteri shkaktohet nga:

- A) fiksimi i bilirubinës së palidhur në bërthamat trunore
- B) fillimi i parakohshëm i ablaktacionit
- C) anemia nga mungesa e hekurit
- D) ikteri nga qumështi i gjirit

33. Terapia rehidruese orale është trajtim i zgjedhur për të gjithë fëmijët e dehidruar, me përjashtim të:

- A) të vjella dhe temperaturë e lartë,
- B) koma ose shok,
- C) shigelozë,
- D) helmim ushqimor

34. Ndërlikimi më i shpeshtë i Salmonelozës është:

- A) prolapsi rektal
- B) anemia
- C) dehidrimet e tipeve të ndryshme
- D) meningiti

35. Cili nga ekzaminimet e mëposhtme nuk ka vlerë në shigelozë?

- A) koprokultura
- B) hemokultura
- C) kërkimi për pus e gjak në feçe
- D) gjak komplet

36. Në dehidrimin hipertoni vuan më shumë:

- A) sistemi kardiovaskular
- B) sistemi nervor
- C) trakti tretës
- D) sistemi limfatik



37. Tetanosi neonatal ka të vërteta të gjitha, me përjashtim të:
- A) shkakton sepsis
  - B) shkakton kontraktura muskulare
  - C) shkakton fraktura të kockave
  - D) shkakton trismus
38. Fëmija postmatur është i lindur:
- A) përpara 37 javësh moshë shtatzënie
  - B) me peshë nën 2500 g
  - C) pas javës 42 të shtatzënisë
  - D) nga 37 në 42 javë moshë shtatzënie
39. Mekonium quhet:
- A) qumështi i ditëve të para pas lindjes
  - B) një keqformim i lindur i traktit gastrointestinal
  - C) një sëmundje ngjitëse e transmetuar nga nëna
  - D) jashtëqitja e parë e bebit
40. Doza e Acetaminofenit (Paracetamol) në fëmijë është:
- A) 2 mg/kg për çdo marrje,
  - B) 5 mg/kg për çdo marrje,
  - C) 15 mg/kg për çdo marrje,
  - D) 50 mg/kg për çdo marrje,
41. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për stenozen hipertrofike të pilorit:
- A) të vjella që në lindje
  - B) fillon reth muajit të parë
  - C) ka prani të bilës në të vjella
  - D) ka humbje të oreksit
42. Sa është sasia e Tresolit që përdoret për rehidrim oral në dehidrimin e lehtë?
- A) 10 mg/kg peshë
  - B) 20 mg/kg peshë,
  - C) 50 mg/kg peshë,
  - D) 100 mg/kg peshë
43. Forma e dehidrimit (i lehtë-i mesëm-i rëndë) tek fëmija vlerësohet me të gjitha, me përjashtim të:
- A) matja e presionit arterial,
  - B) thellimi i syve,
  - C) dhimbja e kokës,
  - D) niveli i fontanelës së madhe
44. Shkaktarët më të shpeshtë të diarresë në fëmijë (rreth 70% e diarreve) janë:
- A) viruset
  - B) bakteret
  - C) mykrat
  - D) asnjëri

45. Doza e Adrenalinës subkutan për trajtimin e shokut anafilaktik është:
- A) 1 mg për çdo 10 kg peshë,
  - B) 0.5 mg për çdo 10 kg peshë,
  - C) 0.1 mg për çdo 10 kg peshë,
  - D) 10 mg për çdo 10 kg peshë
46. Dhënia e vitaminës K tek i porsalinduri duhet të jetë:
- A) sistematike-e detyrueshme për çdo të porsalindur
  - B) e këshillueshme,
  - C) e panevojshme tek fëmija që ushqehet me gji,
  - D) vetëm në rast hemorragjie të jashtme
47. Sindromi Reye lidhet me përdorimin e:
- A) Aspirinës
  - B) Aminofilinës
  - C) Amfetaminës
  - D) Antibiotikëve
48. Njollat e Koplik-ut janë karakteristike e:
- A) Rubeolës
  - B) Varicelës
  - C) Fruthit
  - D) Skabiesit
49. Ekzantema që shfaqet edhe në lëkurën me flokë flet për:
- A) Rubeolë
  - B) Varicelë
  - C) Fruth
  - D) Skarlatinë
50. Rashi kutan makulo-papulo-vezikular, i shoqëruar me temperaturë të lartë dhe prurit flet për:
- A) Rubeolë
  - B) Varicelë
  - C) Fruth
  - D) Skarlatinë
51. Janë komplikacione të varicelës të gjitha, me përjashtim të:
- A) Qelbëzimi i elementeve kutane
  - B) Sindromi Reye
  - C) Glomerulonefriti
  - D) Herpes Zoster
52. Shenja madhore e glomerulonefritit akut është:
- A) Proteinuria
  - B) Hematuria
  - C) Hipertensioni arterial
  - D) Anemia

53. Për vaksinimin sipas kalendarit të vaksinimit janë të vërteta të gjitha, me përjashtim të:

- A) Është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët
- B) Nuk këshillohet të bëhet për fëmijët e lindur para kohe
- C) Ndhmon në krijimin e imunitetit të fëmijës
- D) Për aplikimin e vaksinave duhen respektuar afatet kohore sipas këtij kalendarit

54. Një i porsalindur klasifikohet AGA, kur:

- A) Pësia është midis 3-97% percentile
- B) Gjatësia është midis 3-97 % percentile
- C) Perimetri i kokës është midis 3-97% percentile
- D) Të gjitha

55. Një i porsalindur klasifikohet si SGA kur:

- A) Pësia është nën 3% percentile
- B) Gjatësia është nën 3% percentile
- C) Perimetri i kokës është nën 3 % percentile
- D) Të gjitha

56. Një i porsalindur klasifikohet si LGA kur:

- A) Pësia është mbi 97% percentile
- B) Gjatësia është mbi 97 % percentile
- C) Perimetri i kokës është mbi 97 % percentile
- D) Të gjitha

57. Trajtimi i ikterit përfshin:

- A) ushqyerjen sa më shpesh me gji
- B) fototerapi
- C) eksanguinotransfuzion
- D) të gjitha

58. Një i porsalindur me ikter ka këto shenja klinike:

- A) zverdhje të lëkurës dhe të mukozave
- B) nuk kap gjirin
- C) i plogësht
- D) të gjitha

59. E vjella në refluksin gastro-ezofageal ndodh:

- A) mënjëherë pas ushqyerjes
- B) para ushqyerjes
- C) rreth 1-2 orë pas ushqyerjes
- D) asnjëra

60. E vjella në stenozen hipertrofike të pilorit ndodh:

- A) mënjëherë pas ushqyerjes
- B) para ushqyerjes
- C) rreth 1-2 orë pas ushqyerjes
- D) asnjëra

61. Ushqyerja me gji ka përparësi ndaj asaj me qumësht artificial, sepse:

- A) ka më shumë IgA

- B) ka aminoacide të rëndësishme
- C) rrit lidhjen psiko-afektive nënë-fëmijë
- D) të gjitha

62. Në ekzaminimin e parë të bebit gjithmonë duhet parë:

- A) kalueshmëria anale
- B) kalueshmëria nazale
- C) kalueshmëria ezofago-gastrike
- D) të gjitha

63. Në sallën e lindjes asnjëherë nuk duhet të mungojë:

- A) burimi i oksigjenit
- B) ngrohësi i ambjentit
- C) pelenat e ngrohta
- D) asnjëra

64. Një i porsalindur klasifikohet si serotin kur lind:

- A) para javës së 37-të të shtatzanisë
- B) pas javës së 42-të të shtatzanisë
- C) midis 37-41 javë shtatzanie
- D) asnjëra

65. E vjella në stenozen hipertrofike të pilorit është:

- A) përmbajtje qumështi
- B) qumësht i prerë si hirë
- C) më përmbajtje bile
- D) asnjëra

66. E vjella në refluksin gastro-ezofageal është:

- A) me përmbajtje qumështi
- B) qumësht i prerë si hirë
- C) me përmbajtje bile
- D) të gjitha

67. Cilën nga sëmundjet e mëposhtme shfaq më shpejt prematuri:

- A) papjekuri të sistemit respirator
- B) papjekuri të sistemit lokomotor
- C) papjekuri të sistemit nervor
- D) asnjërën

68. Cilën nga sëmundjet shfaq më shpesh prematuri:

- A) papjekuri të sistemit respirator
- B) papjekuri të sistemit gastro-intestinal
- C) papjekuri të sistemit nervor
- D) të gjitha

69. Hipotermia ose temperatura e ulët është karakteristike e:

- A) bebit prematur
- B) bebit hipotrof
- C) bebit serotin

D) asnjëra

70. Përpara një fëmije prematur cilën do të vlerësoni më shumë:

- A) vështirësinë në frymëmarrje
- B) hypogliceminë
- C) hypotermisë
- D) të gjitha

71. Një fëmijë serotin paraqet më së shpeshti:

- A) asfiksi në lindje
- B) vështirësi respiratore
- C) hipoglicemi
- D) të gjitha

72. Një fëmijë që lind SGA paraqet më së shumti:

- A) hypoglicemi
- B) asfiksi në lindje
- C) vështirësi në frymëmarrje
- D) të gjitha

73. Anomalitë e bashkëlindura janë më tepër karakteristike e:

- A) fëmijëve të lindur në term
- B) fëmijëve të lindur SGA
- C) fëmijëve të lindur LGA
- D) asnjëra

74. Një fëmijë që lind LGA paraqet më së shumti:

- A) hypoglicemi
- B) trauma të lindjes
- C) vështirësi në frymëmarrje
- D) të gjitha

75. Përpara një neonati të sëmurë, gjithmonë duhet të bëjmë:

- A) sigurimin e rrugëve ajrore të lira
- B) të ofrojmë oksigjeno-terapi
- C) monitorojmë shenjat vitale
- D) të gjitha

76. Çfarë duhet të shmangim tek një neonat i sëmurë:

- A) banja
- B) ushqyerja
- C) ekzaminimi
- D) të gjitha

77. Çfarë duhet të bëjmë para një fëmije të sëmurë:

- A) të trajtojmë problemin imediat
- B) të gjejmë pse fëmija është sëmurë dhe të trajtojmë shkakun
- C) të monitorojmë çdo faktor rreziku
- D) të gjitha

78. Kemi takikardi neonatale kur:

- A) frekuenca kardiake është <100/min
- B) frekuenca kardiake është >180/min
- C) frekuenca kardiake është 140-160/min
- D) asnjera

79. Kemi takipne neonatale kur:

- A) frekuenca respiratore është <20/min
- B) frekuenca respiratore është >60/min
- C) frekuenca respiratore është 20-60/min
- D) të gjitha

80. Llojet e apnoeve janë:

- A) me origjinë qendrore
- B) me origjinë obstructive
- C) të përziera
- D) të gjitha

81. Ushqyerja me sondë këshillohet tek:

- A) fëmijët që janë <32 javë moshë barre
- B) që kanë vështirësi në thithje-gëlltitje
- C) që kanë një sëmundje akute të frymëmarrjes
- D) të gjitha

82. Kur raporti nënë-fëmijë ecën keq çfarë mund të presim:

- A) braktisje të fëmijës
- B) zhvillim të mangët fizik
- C) crregullime të sjelljes së fëmijës
- D) të gjitha

83. Kush e përmirëson raportin nënë-fëmijë:

- A) të jemi të duruar me prindërit pa përvojë
- B) t'u japim shpresë atyre
- C) t'i lejojmë që të qëndrojnë pa kufizim me fëmijën
- D) të gjitha

84. Mënyra më e përdorshme për matjen e temperaturës tek bebet është:

- A) aksilare
- B) rektale
- C) matja në lëkurën e barkut
- D) të gjitha

85. Një reanimim i suksesshëm varet nga:

- A) parashikimi i një lindje asfiktike
- B) fillimi i menjëhershëm i veprimeve reanimatore
- C) kryerja e veprimeve reanimatore me saktësi
- D) të gjitha

86. Infeksioni neonatal ka si shenja klinike:

- A) konvulsione

- B) hipotoni
- C) çrregullime të ritmit të zemrës
- D) të gjitha

87. Cila nga masat e mëposhtme duhet marrë në një fëmijë me shok anafilaktik të rëndë:

- A) lirimi i rrugëve të frymëmarrjes
- B) oksigjenimi
- C) përdorimi i adrenalinës
- D) të gjitha

88. Obeziteti është:

- A) Një tregues mbiushqyerje
- B) Një tregues nënushqyerje
- C) Një formë malnutricioni
- D) Asnjëra

89. Diarrea nga Shigella karakterizohet klinikisht nga:

- A) diarre me mukus dhe gjak
- B) temperaturë e lartë
- C) dhimbje barku
- D) të gjitha

90. Spazmofilia është pasojë e:

- A) Hipokalçemisë
- B) Hiperkalcemisë
- C) Hipokalçemisë dhe hiperkalcemisë
- D) Asnjëra

91. Spazmofilia paraqitet klinikisht me:

- A) konvulsione parciales-të pjesshme
- B) konvulsione të gjeneralizuara
- C) konvulsione të dukshme ose që provokohen
- D) të gjitha

92. Komplikacionet më të shpeshta të refluksit gastroezofageal janë:

- A) infeksione të përsëritura respiratore
- B) anemia
- C) otiti
- D) të gjitha

93. Kraniotabes është shenjë klinike e:

- A) Rakitit
- B) Hipovitaminozës A
- C) Rakitit dhe hipovitaminozës A
- D) Asnjëra

94. Konvulsionet janë:

- A) urgjencë mjekësore
- B) trajtohen me diazepam-valium
- C) doza=0.5 mg/kg peshë në një marrje/ për rectum

D) të gjitha

95. Disa komplikacione afatgjata të diabetit janë:

- A) dëmtimi i shikimit
- B) dëmtimi i funksionit renal
- C) ulçera trofike kryesisht në këmbë
- D) të gjitha

96. Meningiti i latantit ka:

- A) Konvulsione
- B) Përgjumësi
- C) Apnoe
- D) Të gjitha

## **7. Infermieristikë Pediatrie, Puerikulture dhe Neonatologjie**

1. Aspirimi i lëngut amniotik tek fëmija gjatë lindjes duhet të kryhet jo më shumë se:

- A) 5sek
- B) 10sek
- C) 10min
- D) 15min

2. Pas sa orësh normalizohet temperatura pas lindjes?

- A) 6min
- B) 8min
- C) 5orësh
- D) 8orësh

3. Kush është pozicioni që vendoset fëmija me çrregullime të buzës të lepurit pas operacionit?

- A) shtrirë mbi barke
- B) shtrirë anash
- C) pozicion semifoler
- D) shtrirë me kurriz

4. Pas sa ditësh kthehet në normë faktori i koagulimit mbas lindjes tek fëmija?

- A) 7-10 ditësh.
- B) 12-15 ditësh
- C) 16-19 ditësh
- D) 20-25 ditësh

5. Me çfarë pastrohet mukoza e gojës në fëmijët që është me stenoz të pilorit?

- A) solucion bikarbonat
- B) solucion nitrat
- C) solucion gencian violet
- D) solucion glukoz

6. Edema serosanguine mund të shoqerohet me?

- A) frakture të kafkës



- B) petëkie ose ekimoza
- C) shkollitje të lëkurës
- D) deformin të gojës

7. Cefalofematoma është një hemoragji që ndodh në zonën ndërmjet?

- A) lëkurës dhe kockës
- B) kockës dhe periostit
- C) trurit dhe kockës
- D) periostit dhe trurit

8. Zhvillimi pamor i fëmijës së porsalindur është rreth një gjatësie:

- A) 20 cm
- B) 22cm
- C) 24cm
- D) 28cm.

9. Femija fillimisht kur lind aspirohet nga:

- A) hunda
- B) goja
- C) veshi
- D) syri

10. Gjatë fototerapisë tek eritroblastozen fetale, fëmija duhet të marrë lëngje në ditë:

- A) 20%
- B) 25%
- C) 30%
- D) 35%

11. Kush janë shenjat që fëmija paraqet në një fraktur të klavikulës?

- A) asimetri në refleksin moro
- B) paraliz të krahut
- C) një hemoragji të krahut
- D) demtime të trupit

12. Sa janë vlerat e bilirubinës kur ikteri fiziologjik ka filluar të shfaqet në anësit e poshtme?

- A) 10 mg/dl
- B) 15 mg/dl
- C) 20 mg/dl
- D) 25 mg/dl

13. Paraplegjia prek këto legjione:

- A) Vetëm 1 gjymtyre
- B) Vetëm 1 pjese të trupit
- C) Katr gjymtyret dhe trupin .
- D) 2 kembet dhe trungun e trupit.

14. Faza sensomotore kujt moshe i perket sipas Piazhe:

- A) lindje deri ne 2vjeç

- B) 3 deri në 4 vjeç
- C) 5 deri në 7 vjeç
- D) 8 deri në 10 vjeç

15. Shpirti i inisiatives kundrejt ndjenjës së fajit kujt moshe i perket?

- A) lindje deri 2 vjec
- B) 3-6vjec
- C) 7-11 vjeç
- D) 13-15vjec

16. Rrugët e infektimit të eritrodermis?

- A) Transplacentare
- B) Ushqyerja artificiale
- C) Frymëmarrja
- D) Veshjet

17. Presioni sistolik i gjakut tek infanti:

- A) 15- 20
- B) 30-40
- C) 50-60
- D) 70-90

18. Presioni sistolik i gjakut tek fëmijet e vegjël:

- A) 15-20
- B) 30-40
- C) 50-70
- D) 80-100

19. Presioni sistolik i gjakut tek fëmijet e rritur:

- A) 15-20
- B) 20-40
- C) 50-70
- D) 90-110

20. Shkalla e respiracionit tek infanti:

- A) 10-15
- B) 20-25
- C) 30-40
- D) 50-60

21. Shkalla e respiracionit tek fëmijet e rritur:

- A) 15-20
- B) 30-40
- C) 50-60
- D) 70-80

22. Shënjat klinike kur kemi një ikter të avancur:

- A) fontanela e bonbuar
- B) klithma
- C) dispne

D) takikardi

23. Me çfare shenjash shoqërohet atrezia biliare?

- A) distëcion abdominal
- B) dhimbje këmbe
- C) dhimbje koke
- D) nauze

24. Manifestimet klinike të sindromës hemoragjike:

- A) gjakosje të umbelikulit
- B) dhimbje barku
- C) dhimbje këmbe
- D) nauze

25. Simptomat e tetanozit neonatal:

- A) spazma të muskulaturës së qafës dhe rigiditet
- B) të vjella
- C) diare
- D) dhimbje barku

26. Shenjat klinike të paralizës faciale:

- A) nuk mbyll plotësisht syrin
- B) nuk merr dot frym
- C) nuk lëviz krahun
- D) nuk lëviz trupin

27. Sipas Frojdit kujt moshe i perket staid latent:

- A) 1-4 vjeç
- B) 6-12 vjeç
- C) 15-18 vjeç
- D) 20-25 vjeç

28. Apneja shoqërohet me:

- A) bradikardi
- B) dhimbje barku
- C) nauze
- D) diare

29. Kush janë format që çojnë në hernie umbelikale?

- A) shtrëngim ne momentin e jashqitjes
- B) dhimbje këmbe
- C) dhimbje barku
- D) dhimbje koke

30. Kush janë faktorët që kanë lidhje me problemin e sindromës hemoragjike?

- A) mungesa e vit K nga nëna
- B) mungesa e oreksit
- C) nauze
- D) diare

31. Paraliza e nervit frenik shkakton paraliz të:
- A) diafragmës
  - B) krahut
  - C) kembës
  - D) barkut
32. Çfarë ndodh në organizëm në fazën e 5 të helmimit nga hekuri?
- A) zhvillohet stënoza e pilorit
  - B) dëmtim të mëlçis
  - C) dëmtim të veshkave
  - D) dëmtim të zemrës V.2
33. Tek kriza vazo-okluzive e drepanocitozes simptomat më madhore janë:
- A) altralgji
  - B) temperaturë
  - C) anemi
  - D) dhimbje
34. Kur epistaksin e kemi nga artëria etmoide ka lidhje më shume me:
- A) traumat
  - B) sëmundjet sistëmiqe
  - C) dëmtime të zemrës
  - D) dëmtime të gojës
35. Në rast se trupi i huaj është i vogël dhe kalibri i bronkut është i madh do kemi këto shenja:
- A) fishkëllim
  - B) vështirësi të frymarrjes
  - C) sekrecione
  - D) dispne
36. Në rast se trupi i huaj ka bere nje bllokim të pjesshem të lymenit do kemi:
- A) Emfizem obstruktive
  - B) Atelektaze
  - C) Pneumotoraks
  - D) Bronkit
37. Kur kemi një infeksion i adenoidit kemi këto shenja kryesore:
- A) dhimbje veshi
  - B) merr frym me gojë
  - C) gjakrrjedhje nga hunda
  - D) gërrhet
38. Respiracioni i pafrytshëm lidhet me:
- A) deficitin e volumit të lëngjeve
  - B) rritjen e kërkesave metabolike
  - C) rritjen e sekrecioneve
  - D) inflamacionin e pemës trakeo-bronkiale
39. Gromerulonefriti akut futët në grupin e sëmundjeve të sistëmit urinar, ku ato do ti quajmë:
- A) reaksion inflamatore

- B) reaksion indor
- C) ulje të imunitëti
- D) sëmundje infektive

40. Në faktorët endokrinologjik tek azma:

- A) tirotoksikoza e përmison azmën
- B) e keqëson gjëndjen
- C) është neutrale
- D) kemi ndikim të fuqishëm

41. Tek azma cilat janë elementë që kanë veprim obstruktiv mbi bronke?

- A) makrofaget
- B) monocidet
- C) bikarbonati
- D) glukonatë

42. Shenjat e intoksikimit nga digogsina:

- A) nauze
- B) lipotëmi
- C) hipoglicemi
- D) anoreksi

43. Tek azma frymarrja e pa frytshme lidhet me:

- A) bllokimin e rrugëve ajrore
- B) përmisimin e sëmundjes
- C) përgjigjja jo e mirë ndaj mjekimit
- D) nga sekretimet e shumta.

44. Azma përfaqëson një:

- A) Dëmtim funksional
- B) Obstruksion të rrugeve respiratore
- C) Sekrecione të shumta
- D) Mjekime jo specifike

45. Haemathrosis është gjakrrjedhje në:

- A) në toraks
- B) në SNQ
- C) në artikulacione
- D) në traktin gastro-intëstinale

46. Parotiti është një sëmundje:

- A) e gjëndrave limfatike
- B) endemike sporadike
- C) enët e gjakut
- D) sistëmin nervor

47. Shkaktari i fruthit është virusi:

- A) virusi RNA
- B) i grupit të herpoviruseve
- C) virusi measles

D) virusi i gripit

48. Në bronkiolit pas hyrjes së virusit kemi këto pasoja:

- A) vështirësi në frymarrje
- B) infiltrim peribronkial
- C) bllokim të anës së prekur
- D) zmadhim të anës së prekur

49. Tipari karakteristik i fibrozës cistike është:

- A) disfunkcion i sipërfaqeve epitëliale
- B) mosfunktionimit të shkëmbimit të brëndshëm të gjëndrave
- C) disfunkcionit të bërthamës qelizore të gjëndrave.
- D) mos oksigjenimi i organizmit

50. Fibroza cistike vjen si pasoje e:

- A) çrregullimi i fluksit hidroelektrolitik midis gjëndrave
